

STUDIM MBI TË DREJTËN
NDËRKOMBËTARE
HUMANITARE ZAKONORE



ICRC

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq është (KNKK) është organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur, misioni ekskluzivisht humanitar i së cilës është që ta mbrojë jetën dhe dinjtetin e viktimave të luftës dhe trazirave të brendshme dhe t'u ofrojë ndihmë atyre. Kjo organizatë drejton dhe bashkërendon aktivitetet ndërkombëtare për ndihmë që udhëhiqen nga Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe gjatë konflikteve. Krahas kësaj, ajo përpiqet që t'i parandalojë vuajtjet, duke promovuar dhe përforcuar të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe parimet humanitare universale. E themeluar në vitin 1863, KNKK-ja qëndron në themel të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

Studim mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare Zakonore: Kontribut për ta kuptuar dhe respektuar zbatimin e ligjit në konfliktet e armatosura.

Jean Marie Henckaerts*

Jean Marie Henckaerts është këshilltar ligjor në Sektorin Ligjor të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe shef i projektit të organizatës së të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare. Kohë më parë, së bashku me Louise Doswald-Beck, përgatiti për shtyp veprën në dy vëllime mbi të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare të cilën e botoi Shtëpia Botuese e "Universitetit të Kembrixhit".

Abstrakt

Ky vështrim shpjegon arsyen e hartimit të këtij studimi mbi të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare të filluar kohë më parë nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK), me kërkesën e Konferencës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Në punim përshkruhet si metodologjia ashtu edhe organizimi i studimit kurse në fund jepet një përmbledhje e disa përfundimeve kryesore. Mirëpo, ky punim nuk synon të ofrojë një vështrim të përgjithshëm apo analizë të thukët të këtyre konstatimeve.



- * Ky vështrim shpjegon arsyen e hartimit të këtij studimi mbi të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare të filluar kohë më parë nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK), me kërkesën e Konferencës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Në punim përshkruhet si metodologjia ashtu edhe organizimi i studimit kurse në fund jepet një përmbledhje e disa përfundimeve kryesore. Mirëpo, ky punim nuk synon të ofrojë një vështrim të përgjithshëm apo analizë të thukët të këtyre konstatimeve

Hyrje

Në këto 50 e sa vjet që nga miratimi i konventave të Gjenevës të vitit 1949, njerëzimi ka përjetuar një numër alarmues të konflikteve të armatosura pothuajse në çdo kontinent. Ndërkohë, të katër konventat e Gjenevës së bashku me Protokollet Shtesë të vitit 1977, kanë siguruar mbrojtje ligjore si për personat që nuk kanë marrë pjesë në armiqësitë e drejtpërdrejta apo nuk janë më pjesëmarrës në armiqësi të këtilla (të plagosurit, të sëmurët, anijembyturit, personat e privuar nga liria për shkak të konfliktit të armatosur dhe civilët). Megjithatë, këto marrëveshje janë shkelur shpeshë herë duke pasur si pasojë vuajtjen dhe vdekjen të cilat do të mund të evitoheshin sikur të respektohej më shumë e Drejta Ndërkombëtare Humanitare.

Ndërkaq, mbisundon një mendim i përgjithshëm se shkeljet e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare nuk janë pasojë e mangësisë së rregullave të saj. Ato janë, më parë, pasojë e mungesës së vullnetit për respektimin e rregullave, e mjeteve të pamjaftueshme për zbatimin e tyre, e pasigurisë në zbatimin e tyre në disa rrethana dhe e mungesës së vetëdijshmërisë për këto rregulla nga ana e krerëve politikë, komandantëve, luftëtarëve dhe publikut të gjerë.

Konferenca Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Viktimave të Luftës, e mbajtur në Gjenevë gjatë muajve gusht dhe shtator të vitit 1993, i trajtoi në mënyrë të veçantë mënyrat e shkeljes të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, por nuk propozoi miratimin e dispozitave të marrëveshjeve të reja. Në vend të kësaj, në Deklaratën Finale të miratuar me konsensus, Konferenca ripohoi “Nevojën për të bërë më efikase zbatimin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare” dhe i bëri apel qeverisë Zvicerane që të “caktojë një grup ndërqeveritar me mandat të papërcaktuar të ekspertëve me qëllim të shqyrtimit të mjeteve praktike për respektin e plotë dhe zbatimin e atij ligji, dhe njëherësh ta hartojë raportin që do t’u dërgohej shteteve dhe kuvendit të ardhshëm të Konferencës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Hënës së Kuqe”¹

Grupi ndërqeveritar i ekspertëve për Mbrojtjen e Viktimave të Luftës u takua në Gjenevë në janarin e vitit 1995, me ç’rast miratoi një sërë rekomandimesh që synonin konsolidimin e respektit për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, veçanërisht përmes masave parandaluese që do të siguronin një njohje më të mirë dhe zbatimin më efikas të ligjit. Rekomandimi II i grupit ndërqeveritar të ekspertëve propozoi që:

Të kërkohet nga KNKK-ja, që me ndihmën e ekspertëve të DNH-së (e Drejta Ndërkombëtare Humanitare), të cilët përfaqësojnë rajone të ndryshme gjeografike dhe sisteme të ndryshme ligjore, në konsultë me ekspertët e qeverive dhe të organizatave ndërkombëtare, të hartojë një raport mbi rregullat zakonore të DNH-së që do të aplikohen në konfliktet e armatosuara ndërkombëtare dhe jondërkombëtare, pastaj t’ua dërgojë këtë raport shteteve dhe organizatave kompetente ndërkombëtare.¹

¹ *International Conference for the Protection of the War Victims*, Geneva, 30 August – 1 September 1993, Final Declaration, *International Review of the Red Cross*, No. 296, 1993, pë 381.

² Meeting of the Intergovernmental Group of Experts for the Protection of War Victims, Geneva, 23-27 January 1995, Recommendation II, *International Review of the Red Cross*, No. 310, 1996, p. 84.

Në dhjetorin e vitit 1995, Konferenca e 26 Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Hënës së Kuqe, e mbështeti këtë rekomandim dhe e autorizoi zyrtarisht KNKK-në që të hartojë një raport mbi rregullat dhe normat zakonore në kuadrin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare që do të mund të zbatoheshin në konfliktet e armatosura si ndërkombëtare ashtu edhe jondërkombëtare.²

Pothuaj se dhjetë vjetë më vonë, më 2005, pas kërkimesh të shumta dhe konsultimesh të gjëra me ekspertët, u botua ky raport, të cilit tani i referohemi si studim i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.Zakonore³

Qëllimi

Qëllimi i studimit për të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare ishte tejkalimi i disa problemeve që kishin të bënin me zbatimin e traktat ligjit të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Traktat ligji është i elaboruar mjaft mirë dhe përfshin shumë aspekte të luftimit, duke ofruar mbrojtje një morije të madhe të personave gjatë kohës së luftës dhe duke i kufizuar mjetet e lejueshme dhe metodat e luftimit. Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtojcë, sigurojnë mundësi të shumta për mbrojtjen e personave të cilët nuk marrin pjesë në armiqësi ose nuk janë involvuar drejtë për së drejti në armiqësi. Rregullimi i mjeteve dhe metodave të luftimit daton që nga deklarata e Shën Petersburgut e vitit 1868, nga Rregullat e Hagës të viteve 1899 dhe 1907 dhe nga Protokollin i Gjenevës për Gazër, dhe është shqyrtuar tani së voni edhe në Konventën për Armë Biologjike më 1972, në Protokollet Shtojcë, 1977, në Konventën mbi disa Armë Konvencionale dhe të pesë Protokolleve të saj më 1980, në Konventën për Armët Kimike, 1993, dhe në Konventën e Otavës mbi Ndalimin e Minave Kundër Njeriut, më 1997. Mbrojtja e pasurisë kulturore, në rast të konfliktit të armatosur, është rregulluar në hollësi në Konventën e Hagës me dy Protokollet e saj në vitin 1954. Statuti i Gjyqit Ndërkombëtar Penal i vitit 1998 përmban, veç të tjerash, edhe listën e krimeve të luftës që bien nën juridiksionin e këtij Gjyqi.

Mirëpo, ekzistojnë dy pengesa serioze për zbatimin e këtyre traktateve në konfliktet vijuese të armatosura që shpjegojnë se studimi i të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare është sa i domosdoshëm aq edhe i dobishëm. Para së gjithash, marrëveshjet zbatohen vetëm nga shtetet të cilët i kanë ratifikuar ato. Kjo do të thotë se traktatet e ndryshme të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare përdoren në konflikte të ndryshme të armatosura varësisht nga ajo se cilat marrëveshje ose traktate janë nënshkruar nga shtetet në gjendje lufte. Ndërsa të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 janë ratifikuar pothuajse tërësisht, një gjë e këtillë nuk vlen për marrëveshjet e tjera të së Drejtës Humanitare, p.sh., Protokollet Shtojcë. Megjithatë, Protokollin Shtojcë i është ratifikuar nga mëse 160 shtete, efektshmëria e tij sot është e kufizuar për arsye se disa shtete që janë përfshirë në konflikte të armatosura ndërkombëtare nuk janë nënshkruar të tij.

3 26th International Conference of the Red Cross and Red Crescent, Geneva, 3-7 December 1995, Resolution 1, International humanitarian law: From Law to action; Report on the follow-up to the International Conference for the Protection of War Victims, *International Review of the Red Cross*, No. 310, 1996, 0. 58.

4 Jean-Marie Henckaerts and Louise Doswald-Beck, *Customary International Humanitarian Law*, 2 volumes, Volume I. Rules, Volume II. Practice (2 Parts), Cambridge University Press, 2005.

Njësoj, ndërsa afro 160 shtete e kanë ratifikuar Protokollin Shtojcë II, disa shtete në të cilët zhvillohen konflikte të armatosura jondërkombëtare, nuk e kanë ratifikuar atë. Në këto konflikte të armatosura jondërkombëtare, neni i përbashkët 3 i të katër Konventave të Gjenevës mbetet dëndur e vetmja dispozitë e zbatueshme të së Drejtës Humanitare. Qëllimi i parë i këtij studimi ishte të përcaktojë se cilat rregulla të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare janë pjesë përbërëse e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore dhe si rrjedhojë mund të përdoren nga të gjitha palët e përfshira në konflikt, pa marrë para sysh se a i kanë ratifikuar apo jo traktatet që përmbajnë rregulla të ngjashme.

Së dyti, Traktat ligji i të Drejtës nuk e rregullon hollësisht një numër të madh të konflikteve të sotshme të armatosura, apo të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, për arsye se këto konflikte janë objekt e një numri shumë më të vogël të rregullave se sa konfliktet ndërkombëtare. Vetëm një numër i kufizuar i traktateve zbatohen në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, d.m.th., Konventa e ndryshuar mbi Disa Armë Konvencionale, Statuti i Gjyqit Ndërkombëtar Penal, Konventa e Otavës mbi Ndalimin e Minave Kundër Njerëzore, Konventa mbi Armët Kimike, Konventa e Hagës mbi Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore me Protokollin e saj të Dytë dhe ashtu siç u përmend tashmë, edhe Protokollin Shtojcë II dhe neni III i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës. Ndërsa, neni i përbashkët 3 ka një rëndësi shumë të madhe, ai vetëm siguron një kornizë bazë me standarde minimale. Protokollin Shtojcë II e plotëson nenin e përbashkët 3, por ka më pak hollësi se rregullat që vlejnë për konfliktet e armatosura ndërkombëtare në Konventat e Gjenevës dhe në Protokollin Shtojcë I.

Protokollin Shtojcë II përmban 15 nene të rëndësishme, ndërsa Protokollin Shtojcë I, ka më se 80 nene. Ndërsa vet numrat nuk e sqarojnë tërësisht këtë qështje ato janë një shenjë i dallimeve të konsiderueshme në përdorimin e të traktat ligjit ndërmjet konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe jondërkombëtare, sidomos kur është fjala për rregullat dhe definicionet e hollësishme. Qëllimi i dytë i studimit ishte të konstatojë nëse e Drejta Ndërkombëtare dhe Zakonore mund t'i rregullojë më hollësisht konfliktet e armatosura jondërkombëtare se traktat ligji, dhe nëse ai i rregullon ato më mirë, atëherë duhet konstatuar se deri në ç'masë i rregullon ato.

Metodologjia

Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare e përshkruan ligjin zakonor ndërkombëtar si “një praktikë e përgjithshme e miratuar nga ligji”⁴. Sipas një mendimi të përgjithshëm, ekzistenca e normës së të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, kërkon praninë e dy elementeve, respektivisht praktikën shtetërore (usus) dhe besimin se ka nevojë për një praktikë të tillë, të ndaluar apo edhe të lejuar, varësisht nga karakteri i ligjit si lëndë juridike (opinio juris sive necessitatis). Pikërisht sikur se thuhet për Gjykatën Ndërkombëtare në rastin e zonave bregdetare: “Është më se e qartë se lëndën e Ligjit Ndërkombëtar Zakonor duhet kërkuar në praktikën aktuale dhe në *opinio juris* të shteteve”.⁵ Domethënia dhe përmbajtja e saktë e këtyre dy elementeve kanë qenë temë e

⁴ Statute of the International Court of Justice, Article 38 (1) (b)

⁵ International Court of Justice, *Continental Shelf case (Libyan Arab Jamahiriya v. Malta)*, Judgment, 3 June 1985, *ICJ Reports 1985*, pp. 29-30, 27

një numri të madh të shkrimeve akademike. Qasja për të konstatuar nëse ekziston rregulli i të Drejtës Zakonore të Përgjithshme Ndërkombëtare ishte një çështje klasike e trajtuar nga Gjykata Ndërkombëtare, veçanërisht në rastin e zonave bregdetare të Detit të Veriut.⁶

Praktika shtetërore

Praktika shtetërore duhet të vështrohet nga dy kënde: së pari, çfarë praktike i kontribuon formimit të Ligjit të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore (përzgjedhja e praktikës shtetërore); dhe së dyti, sa i kontribuon kjo praktikë rregullit të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore (vlerësimi i praktikës shtetërore).

Përzgjedhja e praktikës shtetërore

Si aktet fizike ashtu edhe ato verbale të shteteve përbëjnë një praktikë e cila i kontribuon formimit të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore. Aktet fizike, bie fjala, përfshijnë qëndrimin në fushë të betejës, përdorimin e disa llojeve të armëve dhe qëndrimin ndaj kategorive të ndryshme të personave. Aktet verbale përfshijnë doracakët ushtarak, legjislacionin kombëtar, vendimet e gjyqit me fuqi ligjore kombëtare, udhëzimet për forcat e armatosura dhe të sigurimit, komunikatat ushtarake gjatë luftës, protestat diplomatike, mendimet e këshilltarëve ligjor zyrtar, komentet e qeverive mbi projekt-traktatet, vendimet ekzekutive dhe rregulloret, paraqitja para gjykatave ndërkombëtare, deklaratat në forumet ndërkombëtare dhe qëndrimet qeveritare ndaj rezolutave të aprovuara nga organizatat ndërkombëtare. Kjo listë tregon se praktika e organeve ekzekutive, legjislative dhe juridike mund t'i kontribuojë formimit të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore. Negociatat dhe miratimi i rezolutave nga organizatat ose konferencat ndërkombëtare, së bashku me shpalljen e votimeve, janë akte ku përfshihen shtetet. S'do mend se me pak përjashtime rezolutat normalisht nuk janë të obligueshme vetvetiu, prandaj vlerësimi që i bëhet ndonjë rezolute të veçantë gjatë vlerësimit të formimit të normës të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, varet nga përmbajtja e saj, shkalla e pranueshmërisë së saj dhe nga konsekuenca e praktikës përkatëse të një shteti.⁷ Sa më tepër që përkrahet një rezolute, aq më tepër rëndësi duhet t'i kushtohet asaj.

Megjithëse vendimet e gjykatave ndërkombëtare janë burime plotësuese të së drejtës Ndërkombëtare,⁸ ato nuk përbëjnë praktikën shtetërore. Arsyeja është se, për dallim nga gjykatat kombëtare, gjykatat ndërkombëtare nuk janë organe shtetërore. Sidoqoftë, vendimet e gjykatave ndërkombëtare kanë peshën e tyre sepse vet fakti i një vendimi nga një gjykatë ndërkombëtare që dëshmon se ekziston norma e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, përbën një dëshmi bindëse në një rast të tillë. Përveç kësaj, për shkak të vlerës paraprake të vendimeve të tyre, gjykatat ndërkombëtare mund t'i kontribuojnë po ashtu paraqitjes së normës të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore duke ndikuar në praktikën e mëtejme të shteteve dhe të organizatave ndërkombëtare.

⁶ International Court of Justice, *North Sea Continental Shelf cases*, Judgment, 20 February 1969, *ICJ*

⁷ Rëndësia e këtyre kushteve është theksuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, *Legality of Threat or Use of Nuclear Weapons*, Advisory Opinion, 8 July 1996, *ICJ Report 1996*, pp. 254-255, 70-73.

⁸ Statute of the International Court of Justice, Article 38 (1)(d).

Praktika e grupeve të armatosuar kundërshtare, si p.sh, kodet e mirësjelljes, impenjimet e shpallura për respektimin e disa rregullave të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe të deklaratave të tjera, si të këtylla nuk përbëjnë praktikën shtetërore. Ndërsa një praktikë e këtyllë mund të përmbajë prova të pranimit të disa rregullave në konfliktet e armatosura me karakter jondërkombëtar, domethënia legjitime e saj është e paqartë, ndaj si rrjedhojë, nuk mund të mbështetesh në të për të provuar ekzistencën e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore. Shembujt nga një praktikë e tillë gjenden në pjesën nën titullin “Praktikat e tjera”, në vëllimin II të këtij studimi.

Vlerësimi i praktikës shtetërore

Praktika shtetërore duhet të kihet parasysh për të konstatuar se a është aq “e ngjeshur” ose e shpeshtë ajo në mënyrë që të krijojë një rregull të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore.⁹ Për të formuar një normë të së Drejtës Zakonore Ndërkombëtare, praktika shtetërore duhet të jetë me të vërtetë unike, ekstensive dhe reprezentative.¹⁰ Le të shohim më hollësisht se çfarë domethënie ka kjo.

E para, praktika shtetërore për të krijuar një ligj të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, duhet të jetë pothuajse tërësisht uniforme ose duhet të ketë njëformësi. Shtete të ndryshme nuk duhet të kenë dallime të mëdha në qëndrimet e tyre. Jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare tregon se praktika e kundërt, e cila duket se e rrezikon uniformitetin e praktikës përkatëse, nuk e pengon formimin e normës të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore nëse kjo praktikë nuk dënohet nga shtetet e tjera ose nuk mohohet nga vet qeveria. Përmes dënimit apo mohimit të këtyllë, konfirmohet rregulla në fjalë.¹¹

Kjo ka veçanërisht rëndësi për një numër të normave ose rregullave të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, për të cilën ka mjaft prova në praktikën shtetërore për përkrahjen e një norme të këtyllë, paralelisht me dëshminë e përsëritur të shkeljes së kësaj norme. Edhe nëse shkeljet e kësaj norme janë shoqëruar me justifikime nga ndonjë palë e interesuar dhe/ose dënuar nga shtetet e tjera, ato nuk kanë një karakter të atillë sa që jenë në gjendje të sfidojnë ekzistencën e normës në fjalë. Shtetet që dëshirojnë të ndryshojnë një ligj ekzistues të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore duhet të veprojnë në këtë mënyrë nëpërmjet praktikës së tyre zyrtare dhe të paraqiten se veprojnë me drejtësi.

E dyta, për të ekzistuar një rregull e të Drejtës së Përgjithshme Zakonore, praktika e shtetit përkatës duhet të jetë si *ekstensive* ashtu edhe *reprezentative*. Mirëpo, ajo praktikë nuk është e thënë të jetë universale; mjafton një praktikë “e gjithmbarshme”.¹² Nuk

⁹ Fjala “e ngjeshur” (dense) në këtë kontekst e ka zanafillën nga studimi i Sir Humphrey Waldock-ut, “General Course on Public International Law”, *Collected Courses of the Hague Academy of International Law*, Vol. 106, 1962, p.44.

¹⁰ International Court of Justice, *North Sea Continental Shelf cases*, supra note 7, p. 43, 74.

¹¹ *Shih* International Court of Justice, *Case concerning Military and Paramilitary Activities in and against Nicaragua (Nicaragua v. United States)*, Merits, Judgment, 27 June 1986, ICJ Reports 1986, p. 98, 186.

¹² International Law Association, Final Report of the Committee on the Formation of Customary (General) International Law, Statement of Principles Applicable to the Formation of General Customary International Law, Report of the Sixty-Ninth Conference, London, 2000, Principle 14, p.734 (më tej “ILA Report”).

kërkohet një numër apo një përqindje e saktë e shteteve në ndonjë rast të këtillë. Një prej arsyeve se pse është e pamundur për të dhënë një shifër të përpiktë mbi shkallën e pjesëmarrjes së nevojshme, është kriteri më tepër cilësor se sa sasior. Me fjalë të tjera, nuk është aq me rëndësi se sa shtete marrin pjesë në këtë praktikë, por është po aq me rëndësi se cilët shtete i përmbahen kësaj praktike.¹³ Sipas fjalëve të Gjykatës Ndërkombëtare në rastin e zonave bregdetare të Detit të Veriut, praktika duhet “të përfshijë përvojën e atyre shteteve, interesat e të cilëve janë veçanërisht të implikuara”.¹⁴

Kjo konsideratë ka dy implikime: (1) nëse paraqiten “të gjitha shtetet veçanërisht të implikuara”, nuk është gjithaq thelbësore për shumicën e shteteve që të marrin pjesë aktive, por ato duhet së paku të pranojnë në heshtje praktikën e “shteteve veçanërisht të implikuara”; dhe (2) nëse “shtetet veçanërisht të implikuara” nuk e pranojnë këtë praktikë, atëherë ajo nuk mund të shëndërrohet në një normë të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, edhe pse nuk është kërkuar apo shpjeguar njëzërit.¹⁵ Kush është “veçanërisht i implikuar”, sipas të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare mund të ndryshojë qëndrimin sipas rrethanave. Lidhur me legjimitetin e përdorimit të armëve verbuese me lazer, p.sh., “shtetet veçanërisht të implikuara” përfshijnë ato shtete që janë identifikuar se janë duke zhvilluar dhe prodhuar armë të këtilla, ndonëse shtetet e tjera ka të ngjarë që të pësojnë prej përdorimit të armëve të këtilla. Në të njëjtën mënyrë, shtetet popullsia e të cilëve ka nevojë për ndihmë humanitare janë të “veçanërisht të implikuara” njësoj si shtetet të cilët shpesh herë japin një ndihmë të këtillë. Sa i përket përdorimit të ndonjë norme të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, vendet që kanë marrë pjesë në një konflikt të armatosur janë “veçanërisht të implikuara”, kur shqyrtimi i praktikës së përdorimit të një rregulle ka patur rëndësi në konfliktin e armatosur. Megjithëse mund të ketë shtete të implikuara në disa fusha të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, është po ashtu e vërtetë se të gjithë shtetet kanë një interes legjitim në kërkesën për respektimin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare nga shtetet e tjera, edhe nëse nuk janë pjesëmarrës në konflikt.¹⁶ Përveç kësaj, të gjitha shtetet mund të pësojnë nga metodat e luftës që përdorin shtetet e tjera. Si rrjedhojë, duhet të merret parasysh përvoja e të gjitha shteteve, pa marrë parasysh se a janë “veçanërisht të implikuara” në kuptimin e plotë të kësaj fjale.

Ky studim nuk e shtron faktin se a është e mundur që të jesh “kundërshtues këmbëngulës” lidhur me ligjet e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Ndërsa nga një anë, një numër i madh i komentatorëve janë të mendimit se është e pamundur të jeshë “kundërshtar ngulmues” përball ligjeve *jus cogens*, nga ana tjetër ka komentatorë të tjerë që dyshojnë në validitetin e vazhdueshëm të konceptit të kundërshtuesit ngulmues.¹⁷ Nëse do ta pranoje se ke mundësi legjitime për t’u bërë kundërshtues ngulmues, shteti përkatës duhet të kundërshtojë formimin e nomës së re gjatë formimit të saj dhe të vazhdojë ta

¹³ *Ibid.*, commentary (d) and (e) to Principle 14, pp. 736-737.

¹⁴ International Court of Justice, *North Sea Continental Shelf cases*, supra note 7, p. 43, 74.

¹⁵ ILA Report, supra note 13, commentary (e) to Principle 14, p. 737.

¹⁶ Shih *Customary International Humanitarian Law*, supra note 4, Vol. I, commentary to Rule 1444.

¹⁷ Për një shqyrtim më të hollësishëm të kësaj çështje, shih Maurice H. Mendelson, “The Formation of Customary International Law”, *Collected Courses of the Hague Academy of International Law*, Vol. 272, 1998, pp. 227-244.

kundërshtojë atë edhe më pas; por, nuk është e mundur që të jesh “kundërshtues konsequent”.¹⁸

Ndërsa, duhet të kalojë një kohë e caktuar para se të dalë në shesh një normë e re e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, njëherësh duhet të kihet parasysh se nuk ekziston një kornizë e veçantë kohore. Ç’është e vërteta, faktori vendimtar në këtë rast është fillimi i praktikës mjaft të ngjeshur, me rregullsi, përmasë dhe përfaqësueshmëri të mjaftueshme.¹⁹

Opinio juris

Nevoja për *opinio juris* për të konstatuar ekzistimin e normës të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, i referohet bindjes legale sipas të cilës një praktikë e veçantë zbatohet “si e drejtë”. Forma në të cilën paraqiten praktika dhe bindja legale mund të ndryshojë vartësisht nga fakti se a nënkupton norma përkatëse edhe ndalimin, a është ajo një obligim apo është vetëm një e drejtë për t’u sjellur në një farë mënyre.

Gjatë përgatitjes së këtij punimi, ishte punë mjaftë e vështirë dhe kryesisht teorike mundësia për të ndarë përpikërisht elementet e praktikës nga bindja legale. Të shpeshtën e herave, akti i njëjtë e pasqyron si praktikën ashtu edhe bindjen legale sikurse që ka vënë në dukje Shoqata e të Drejtës Ndërkombëtare, Gjykata Ndërkombëtare “nuk e ka artikuluar në fakt me aq shumë fjalë për shkak se (kinse) ekzistojnë elemente të ndryshme në të Drejtën Zakonore, sjellja e njëjtë nuk mund t’i shfaqë te dyja”. Në faktë është shpesh herë vështirë ose edhe e pamundur që të veçohen të dy elementet.²⁰ Kjo ndodh për shkak se aktet verbale, si fjala vjen doracakët ushtarakë, konsiderohen si praktikë shtetërore, dhe shpesh herë pasqyrojnë involvimin e bindjes legale njëkohësisht.

Kur ekziston një praktikë e ngjeshur, një *opinio juris* zakonisht është përfshirë në atë praktikë, si rrjedhojë, nuk ka nevojë që të konstatohet veçmas ekzistenca e një *opinio juris*. Në rastet kur praktika është dykuptimshme, atëherë *opinio juris* luan një rol të rëndësishëm për të përcaktuar se a ka rëndësi praktika gjatë formimit të normës zakonore. Kjo ndodh shpeshë me shmangiet, kur shtetet nuk reagojnë ndonëse nuk është e qartë arsyeja. Pikërisht në raste të këtilla, si Gjykata Ndërkombëtare dhe paraardhësja e saj, Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare, bëjnë përpjekje për të konstatuar ekzistencën e ndarë të një *opinio juris* për të konstatuar se nëse shembujt e praktikës dykuptimshme i kanë kontribuar formimit të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore.²¹ Në

¹⁸ ILA Report, supra note 13, commentary (b) to Principle 15, p. 738.

¹⁹ *Ibid.*, commentary (b) to Principle 12, p. 731.

²⁰ *Ibid.*, p. 718 & 10 (c). Për një analizë më të thellë të kësaj teme, shih Peter Haggemacher, “La doctrine des deux elements du droit coutumier dans la pratique de la Cour internationale”, *Revue generale de droit international public*. Vol. 90, 1986, p. 5.

²¹ Shis, p.sh., Permanent Court of International Justice, *Lotus case (France v. Turkey)*, Judgment, 7 September 1927, PCIJ ser. A, No. 10 p. 28 (Gjykata ka konstatuar se shtetet nuk kanë abstenuar nga ndjekja e akteve të papërligjura në anije sepse e ndjenin veten të ndaluar për të vendosur për këtë); International Court of Justice, *North Sea Continental Shelf cases*, supra note 7, pp. 43 – 44 & 76-77 (Gjykata konstatoi se shtetet të cilët e kanë përkufizuar zonën e tyre bregdetare në bazë të parimit të

fushën e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, ku shumë rregulla kërkojnë abstenim nga disa qëndrime të caktuara, shmangiet dhe mangësit paraqesin një problem të veçantë për vlerësimin e opinio juris sepse duhet të vërtetohet se abstenimi nuk është një rastësi, por mbështetet në një besim legjitim. Kur një kërkesë e këtillë për abstenim vërehet si në instrumentet ndërkombëtare ashtu edhe në deklaratat zyrtare, ekzistenca e kërkesës legale për abstenim zakonisht mund të provohet. Për më tepër, abstenimet e këtilla mund të paraqiten pasi që një sjellje e këtillë të ketë krijuar një debat, i cili po ashtu ndihmon për të vërtetuar se abstenimi nuk ishte i rastësishëm, megjithëse nuk është gjithmonë lehtë të provosh abstenimi ka ndodhur nën ndikimin e obligimit legal.

Ndikimi i traktatit

Traktatet po ashtu kanë rëndësi për konstatimin e ekzistencës së Ligjit Ndërkombëtar Zakonor për arsye se ato ndihmojnë për të hedhur dritë se në çfarë mënyre shtetet i trajtojnë disa ligje të të Drejtës Ndërkombëtare. Së këndejmi, ratifikimi, interpretimi dhe zbatimi i një traktati, përfshirë edhe rezervat e deklaratat e interpretimet e bëra pas ratifikimit, janë përfshirë në këtë studim. Në rastet e zonave bregdetare të Detit të Veriut, Gjykata Ndërkombëtare e ka parë të udhës që të ketë parasysh shkallën e ratifikimit të traktatit si një akt të rëndësishëm për vlerësimin e Ligjit Ndërkombëtar Zakonor. Në atë rast, Gjykata ka theksuar se “numri i ratifikimeve dhe i miratimeve që janë siguruar deri më tash, ndonëse është i mirëfillët, nuk është i mjaftueshëm”, sidomos në kontekstin kur praktika jashtë traktatit ka qenë kontradiktore.²² Përkundrazi, në Rastin e Nikaraguas, Gjykata i dha rëndësi të madhe kësaj çështje duke vlerësuar statusin zakonor të normës për mosintervenim, në saje të faktit se Karta e Kombeve të Bashkuara ishte pothuajse tërësisht e ratifikuar.²³ Mund të ketë edhe raste të atilla kur dispozitat e traktatit paqyrojnë Ligjin Zakonor, ndonëse traktati nuk është ende në fuqi, me kusht që të ketë një praktikë të gjatë dhe të mjaftueshme, veçanërisht nga shtetet e involvuara, me ç’rast ka fare pak mundësi për ndonjë kundërshtim të madh ndaj ligjit në fjalë.²⁴

Në praktikë, hartimi i normave të traktateve ndihmon për fokusimin e opinionit legjitim botëror dhe ka një ndikim të pamohueshëm në sjelljet dhe bindjet legale të shteteve. Gjykata Ndërkombëtare e ka konfirmuar këtë në gjykimin e saj në rastin e Zonës Bregdetare, ajo konstatoi se “konventat multilaterale mund të kenë një mundësi shumë të madhe në definimin dhe regjistrimin e ligjeve që lindin nga e drejta zakonore, ose duke i

largësisë së njëjtë nuk kanë vepruar kështu sepse kanë qenë të shtrënguar të veprojnë në këtë mënyrë); ILA Report, *supra* note 13, Principle 17 (vi) and commentary.

²² International Court of Justice, *North Sea Continental Shelf cases*, *supra* note 7, p. 42, & 73.

²³ International Court of Justice, *Case concerning Military Paramilitary Activities in and against Nicaragua*, *supra* note 12, 99-100 & 188. Një faktor tjetër i rëndësishëm në vendimin e Gjykatës ishin rezolutat përkatëse të kuvendit të përgjithshëm të KB, të cilat kanë qenë të aprovuar pa unanimisht, ve/anërisht rezolutat 26, 25 (XXV) mbi marrëdhëniet miqësore midis shteteve e cila u miratua pa ndonjë votë.

²⁴ International Court of Justice, *Continental Shelf case*, *supra* note 6, p. 33, & 34. (Gjykata shqyrtoi dhe konstatoi se koncepti i një zone ekskluzive ekonomike është bërë pjesë përbërëse e Ligjit Zakonor Ndërkombëtar, ndonëse konventa e KB mbi ligjin e detit ende nuk ka hyrë në fuqi, meqë numri i kërkesave për të pasur zona ekskluzive ekonomike është rritur në 56, me ç’rast u përfshinë edhe disa shtete të interesuara).

zhvilluar ato”.²⁵ Në këtë mënyrë Gjykata ka konfirmuar se traktatet mund ta kodifikojnë Ligjin paraprak Ndërkombëtar Zakonor, por njëkohësisht mund t’i vënë edhe themelet për zhvillimin e zakoneve të reja duke u bazuar në normat që janë pjesë e traktateve. Gjykata madje ka marrë guximin që të deklarojë se “ka mundësi që ... një pjesëmarrje e gjerë dhe representative në konventë mund të jetë e mjaftueshme, me kusht që të përfshijë shtetet të cilët kanë interesa të veçanta në këto raste.”²⁶

Ky studim ka një qasje të matur sipas të cilës ratifikimi i gjerë është vetëm një tregues dhe duhet të shqyrtohet në raport me elementet e tjerë të praktikës, veçanërisht të praktikës së shteteve të cilët nuk janë palë të traktatit në fjalë. Praktika e qëndrueshme e shteteve jopalë konsiderohet si dëshmi e rëndësishme pozitive. Ndërkaq praktika e kundërt e shteteve jopalë, konsiderohet si një dëshmi e rëndësishme negative. Praktika e shteteve palë ndaj shteteve jopalë ka po ashtu një rëndësi të veçantë.

Në këtë mënyrë ky studim nuk është përkufizuar vetëm me praktikën e shteteve jopalë kundrejt traktateve relevante të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Ta limitosh studimin duke përfshirë praktikën e vetëm tridhjetë shteteve të cilat nuk e kanë ratifikuar Protokolet Shtojcë, bie fjala, nuk do të ishte konform me kërkesat e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore dhe në praktikën e gjerë dhe reprezentative të saj. Prandaj, shqyrtimi i ekzistencës së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore e ka marrë parasysh këtë me rastin e botimit të punimit, ndërsa Protokollin Shtojcë I ishte ratifikuar nga 162 shtete, Protokollin Shtojcë II ishte nënshkruar nga 157 shtete.

Duhet të theksohet se ky studim nuk ka synuar të përcaktojë karakterin zakonor të çdo traktat ligji të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, prandaj nuk i është përmbajtur strukturës së traktateve ekzistuese. Me këtë rast, ky studim ka synuar të analizojë çështjet në fjalë në mënyrë që të konstatojë se cilat norma të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore mund të zbulohen në mënyrë induktive në bazë të praktikës së shteteve që kanë të bëjnë me këto çështje. Meqë qasja e parapëlqyer me këtë rast nuk e analizon secilën dispozitë të traktatit për të konstatuar në është apo s’është një traktat zakonor, është e pamundur të nxirret përfundimi se një ligj i veçantë i traktatit nuk është zakonor vetëm për shkak se nuk paraqitet i këtyre në këtë studim.

Organizimi i studimit

Për të vendosur për mënyrën më të mirë në përmbushjen e detyrës të besuar nga KNKK, autorët janë konsultuar me një grup të akademikëve ekspertë të të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, të cilët e themeluan Komitetin Drejtues të këtij studimi.²⁷ Komiteti drejtues e miratoi planin e tij aksional në qershorin e vitit 1996, ndërsa kërkimet filluan në tetorin e ardhshëm. Kërkimet u bënë në bazë të burimeve kombëtare dhe ndërkombëtare duke

²⁵ International Court of Justice, *Continental Shelf case*, *supra* note 6, pp. 29-30, & 27.

²⁶ International Court of Justice, *North Sea Continental Shelf case*, *supra* note 7, p. 42, & 73; po ashtu shih ILA Report, *supra* note 13, Principles 20-21, 24, 26 and 27, pp. 754-765.

²⁷ Komiteti Drejtues përbëhej prej profesorëve: Geroges Abi-Saab, Salah El-Din Amer, Ove Bring, Eric David, John Dugard, Florentino Feliciano, Horst Fischer, Françoise Hampson, Theodor Meron, Djamchid Momtaz, Milan •ahovi• and Raul Emilio Vinuesa.

pasqyruar praktikën shtetërore dhe duke u përqendruar në gjashtë pjesët e studimit të identifikuar në planin aksional si:

- Parimi i dallimit
- Personat dhe objektet e mbrojtura në veçanti
- Metodatat e posaçme të luftës
- Armët
- Trajtimi i civilëve dhe i personave *hors de combat* (që nuk marrin pjesë në luftë)
- Zbatimi

Kërkimet nga burimet kombëtare

Meqë shfrytëzimi i burimeve kombëtare është më i lehtë, u mor vendimi që të sigurohet bashkëpunimi i kërkuesve kombëtar. Për të arritur këtë qëllim, u identifikuan kërkues ose grupe kërkuesish në afro 50 shtete (9 në Afrikë, 11 në të dy Amerikat, 15 në Azi, 1 në Australi dhe 11 në Evropë), dhe u kërkua nga ata që të përgatisin raporte për praktikën përkatëse të shteteve të tyre.²⁸ Vendet u përzgjedhën në bazë të përfaqësisë gjeografike si dhe në saje të përvojës së paradokohshme të llojeve të ndryshme të konflikteve të armatosura, me ç'rast janë përdorur një laryshi të metodash të luftës. U mbledhën dhe u hulumtuan si dhe u gjurmuan edhe doracakët ushtarak dhe legjislacioni kombëtar i vendeve që nuk janë mbuluar nga raportet për praktikën shtetërore. Daljen në dritë të këtij studimi e ndihmoi edhe rrjeti i delegacioneve të KNKK anë e mbanë botës dhe mbledhja e gjerë e legjislacioneve kombëtare të siguruara nga Shërbimi Këshilldhënës i KNKK-së për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare.

Kërkimi i burimeve ndërkombëtare

Praktika shtetërore e siguruar nga burimet ndërkombëtare u mblodh nga gjashtë ekipe, me ç'rast çdo ekip u përqendrua në një pjesë të studimit.²⁹ Këto ekipe bënë kërkime dhe gjurmuan praktikatat në kuadrin e Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, përfshirë Unionin Afrikan (Ish-Organizata e Unionit Afrikan), Këshillin e Evropës, Këshillin e Bashkëpunimit të Gjirit, Bashkimin Evropian, Ligën e Shteteve Arabe, Organizatën e Shteteve Amerikane, Organizatën e Konferecës Islamike, dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Vendimet legjitime ndërkombëtare

²⁸ Afrika: Algjeria, Angola, Botsuana, Egjipti, Etiopia, Nigeria, Ruanda, Afrika e Jugut dhe Zimbabve; Amerikat: Argjentina, Brazili, Kanada, Kili, Kolumbia, Kuba, El Salvadori, Nikaragua, Peru, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Uruguai; Azia: Kina, India, Indonezia, Irani, Iraku, Izraeli, Japonia, Jordania, Republika e Koresë, Kuvajti, Libani, Malezja, Pakistani, Filipinet, dhe Siria; Australazia: Australia; Evropa: Belgjika, Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia, Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Federata Ruse, Spanja, Mbretëria e Bashkuar dhe Ish-Jugosllavia.

²⁹ Parimi i dallimit: Profesor Georges Abi-Saab (raportues) dhe Jean – Fran/ois queguiner (kërkues); Personat dhe objektet e mbrojtura në veçanti: Profesor Horst Fischer (raportues) dhe Gregor Schotten dhe Heike Spieker (kërkues); Metodatat e posaçme të luftës: Profesor Theodor Meron (raportues) dhe Richard Desgagne (kërkues); Armët: Profesor Ove Bring (raportues) dhe Gustaf Lind (kërkues); Trajtimi i civilëve dhe i personave *hors de combat*: Fran/oise Hampson (raportues) dhe Camille Giffard (kërkues); Zbatimi: Eric David (raportues) dhe Richard Desgagne (kërkues).

u mblodhën gjithashtu gjerësisht për të siguruar dëshmi të mjaftueshme për ekzistencën e ligjit të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore.

Kërkimet në arkivat e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq

Për t'i realizuar kërkimet e bëra nga burimet kombëtare dhe ndërkombëtare, KNKK u mbështet edhe në arkivat e veta që kanë të bëjnë me pothuajse 40 konflikte të armatosura të paradokohshme (21 në Afrikë, 2 në Amerikat, 8 në Azi, dhe 8 në Evropë).³⁰ Në përgjithësi këto konflikte u zgjodhën në mënyrë që të përfshihen edhe vendet dhe konfliktet që nuk janë shqyrtuar në raportin e praktikës shtetërore.

Rezultati i kësaj qasjeje tri dimensionale – kërkimi nga burimet kombëtare, ndërkombëtare dhe të KNKK-së – ka bërë të mundur që të përfshihen praktikët nga të gjitha anët e botës. Mirëpo, marrë më hollësisht, ky kërkim nuk mund të pretendoj që të jetë i plotë. Studimi u fokusua veçanërisht rreth praktikës së këtyre 30 viteve të fundit për të siguruar se rezultati do të jetë riparashtrimi i të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore bashkëkohore, por aty ku u pa e udhës, u cituan edhe shembuj nga praktika më e vjetër.

Konsultat e ekspertëve

Në serinë e parë të konsultave, KNKK-ja i ftoi ekipet kërkimore ndërkombëtare që të paraqesin një raport të plotë që do të përfshinte vlerësimet nga aspekti i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare të mbështetur në praktikën e mbledhur. Këto raporte të plota u shqyrtuan nga Komiteti Drejtues në tri mbledhjet e tij në Gjenevë në vitin 1998. Raportet e plota u rishqyrtuan, kështu që gjatë raundit të dytë të konsultave, iu paraqiten një grupi të akademikëve dhe ekspertëve qeveritar nga të gjitha rajonet e botës. Më pas, këta ekspertë u ftuan personalisht nga KNKK-ja për të marrë pjesë në dy mbledhje të Komitetit Drejtues më 1999 në Gjenevë, me ç'rast ata e dhanë kontributin e tyre për vlerësimin e praktikës së mbledhur dhe konstatuan edhe disa praktika të posaçme të cilat nuk ishin përfshirë në raport.³¹

³⁰ Afrikë: Angola, Burundi, /adi, /adi-Libia, Republika Demokratike e Kongos, Xhibuti, Eritrea-Jemeni, Etiopia (1973-1994), Liberia, Mozambiku, Namibia, Nigeria-Kameruni, Ruanda, Senegali, Senegali-Mauritania, Sierra Leone, Somalia, Somalia-Etiopia, Sudani, Uganda dhe Sahara Perëndimore; Amerikat: Guatemala dhe Meksikoja; Azia: Afganistani, Gambouhia, India (Xhamu dhe Kashmiri), Papua New Guinea, Sri Lanka, Taxhikistani, Jemeni, dhe Jemeni-Eritrea (po ashtu këto janë edhe nën Afrikë); Evropa: Armenia-Azerbejxhani (Nagorno-Karabahu), Qiproja, Ish-Jugosllavia (konflikti në ish-Jugosllavi 1991-1992), konfliktet në Bosne dhe Hercegovinë (1992-1996), konflikti në Kroaci (Krajina) (1992-1995), Gjorgjia (Apazia), Federata Ruse (/e/enia), dhe Turqia.

³¹ Në këtë konsult morën pjesë personalisht këta akademikë dhe ekspertë qeveritar: Adallah Ad-Douri (Irak), Paul Berman (Mbretëria e Bashkuar), Sadi /aycy (Turqi), Michael Cowling (Afrika e Jugut), Edward Cummings (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), Antonio de Icaza (Meksikë), Yoram Dinstein (Israel), Jean-Michel Favre (Francë), William Fenrick (Kanada), Dieter Fleck (Gjermani), Juan Carlos Gomez Ramirez (Kolumbi), Jamshed A. Hamid (Pakistan), Arturo Hernandez-Basave (Meksiko), Ibrahim Idriss (Etiopi), hassan Kassem Jouni (Liban), Kenneth Keith (Zeland e Re), Githu Muigai (Keni), Rein Mullerson (Estoni), Bara Niang (Senegal), Mohamed Olwan (Jordan), Raul C. Pangalangan (Filipine), Stelios Perrakis (Gre/i), Paulo Sergio Pinheiro (Brazil), Arpad Prandler (Hungari), Pemmaraju Sreenivasa Rao (Ind), Camilo Reyes Rodriguez (Kolumbi), Itse E. Sagay (Nigeri), Harold Sandoval (Kolumbi), Somboon Sangianbut (Tailand), Marat A. Sarsembayev (Kazakistan), Muhammad Aziz Shukri (Siri), Parlaungan Sihombing (Indonezi),

Hartimi i raportit

Shqyrtimi i raportit nga Komiteti Drejtues pas vlerësimit të grupit të akademikëve dhe të ekspertëve qeveritar, shërbeu si bazë për hartimin e raportit final. Autorët e këtij studimi e rishqyrtuan praktikën, i rivlerësuan elementet zakonore, reviduan rendin e ligjeve dhe i formuluan komentet. Këto tekste të formuluaru iu paraqitën edhe Komitetit Drejtues, grupit të akademikëve dhe ekspertëve qeveritar dhe seksionit ligjor të KNKK-së për dhënien e komenteve. Në këtë mënyrë teksti u përfeksionua dhe u plotësua duke marrë parasysh komentet e bëra.

Përmbledhje e përfundimeve

Një numër i madh i dispozitave të Konventave të Gjenevës, duke përfshirë edhe nenin 3, konsiderohen se janë pjesë e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore.³² Njëherësh, meqë Konventën e Gjenevës e kanë nënshkruar 192 palë, ato janë të obligueshme pothuaj se për të gjitha shtetet si një traktat legjitim. Prandaj, karakteri zakonor i dispozitave të konventave nuk ka qenë objekt i këtij studimi. Përkundrazi, studimi u përqendrua rreth çështjeve të cilat janë rregulluar sipas traktateve, por nuk janë ratifikuar tërësisht, veçanërisht Protokollet Shtojcë, Konventa e Hagës për Mbrojtjen e Pronës Kulturore dhe një numër i veçantë i konventave të cilat kanë të bëjnë me çështjet e përdorimit të armëve.

Përshkrimi më poshtë i ligjeve të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore nuk synon t'i shpjegojë përse këto ligje u trajtuan si zakonore dhe as që paraqet praktikën në bazë të të cilës është arritur ky përfundim. Shpjegimi pse një ligj është konsideruar si ligj zakonor gjendet në vëllimin e parë të studimit, ndërsa praktika korresponduese gjendet në vëllimin e dytë.

Konfliktet e armatosura ndërkombëtare

Protokolli Shtojcë I i kishte kodifikuar normat paraprake të së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, njëherësh kishte vënë edhe themelet e formimit të rregullave të reja zakonore. Praktika e mbledhur në kuadrin e studimit tonë sjell dëshmi mbi ndikimin e thellë të Protokollit Shtojcë I në praktikën e shteteve, jo vetëm në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, por edhe në konfliktet e armatosura jondërkombëtare (shih më poshtë). Duhet vënë në dukje se studimi në veçanti konstatoi se parimet bazë të Protokollit Shtojcë I kryesisht janë pranuar dhe përhapur, madje edhe më gjerë se sa sugjeron Protokollit Shtojcë I. Edhe pse studimi nuk synonte që të konstatojë karakterin zakonor të dispozitave të disa traktateve të veçanta, në fund doli në shesh se ka shumë norma zakonore të cilat janë të ngjashme me ato që gjenden edhe në traktat ligjin. Shembuj të

Geoffrey Mames Skillen (Australi), Guoshun Sun (Kinë), Bakhtyar Tuzmukhamedov (Rusi) dhe Karol Wolfke (Poloni).

³² International Court of Justice, *Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons*, supra note 8, pp. 257-258, & 79 and 82 (duke patur parasysh Konventat e Gjenevës) dhe *Case concerning Military and Paramilitary Activities in and against Nicaragua*, supra note 12, p. 114, & 218 (duke pasur parasysh Nenin 3).

gjetur të normave zakonore të cilat kanë dispozita korresponduese në Protokollin Shtojcë I përfshijnë: Parimin e dallimit midis civilëve dhe luftëtarëve dhe midis objekteve civile dhe objektivave ushtarake;³³ ndalimin e sulmeve të rrëmujshe,³⁴ parimi i përpjestimit të caktuar në sulm,³⁵ obligimit për të ndërmarrë masa të mundshme në sulm dhe kundër pasojave të sulmit;³⁶ obligimi për të respektuar dhe mbrojtur personelin mjekësor dhe fetar, njësitë mjekësore dhe transportet,³⁷ ndihma humanitare personelit dhe objekteve,³⁸ dhe gazetarëve civil,³⁹ obligimi për të mbrojtur detyrat mjekësore;⁴⁰ ndalimi i sulmeve kundër lokaliteteve të pambrojtura dhe zonave të çmilitarizuara;⁴¹ obligimi për të siguruar strehim dhe siguri armikut *hors de combat*;⁴² ndalimi i vdekjes nga uria;⁴³ ndalimi i sulmeve kundër objekteve që janë të pazëvendësueshme për mbijetesën e popullatës civile;⁴⁴ ndalimi i përdorimit të padrejtë të emblemeve dhe mashtrimit;⁴⁵ obligimi për respektimin e garancive fundamentale të civilëve dhe të personave *hors de combat*;⁴⁶ obligimi për t'u interesuar për personat e zhdukur,⁴⁷ dhe mbrojtja e veçantë e femrave ose grave dhe fëmijëve.⁴⁸

Konfliktet e armatosura jondërkombëtare

Gjatë këtyre dekadave të fundit ka ekzistuar një praktikë mjaftë e dendur e cila këmbëngulte për mbrojtjen e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare në këto lloj të konflikteve. Kjo praktikë ka pasur ndikim të rëndësishëm në formimin e normës zakonore të zbatueshme në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Sikurse Protokollin Shtojcë I, ashtu edhe Protokollin Shtesë II ka pasur ndikim të madh në këtë praktikë, së këndëjmi shumë klauzole e nene të tij tani konsiderohen si pjesë përbërëse e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore. Shembujt e rregullave që konsiderohen si zakonore dhe të cilët kanë dispozita adekuate në Protokollin Shtesë II, përfshijnë: ndalimin e sulmeve kundër civilëve;⁴⁹ obligimi për respektimin e personelit mjekësor dhe religjioz, të ekipeve mjekësore dhe të transportit;⁵⁰ obligimi për mbrojtjen e detyrës mjekësore;⁵¹ ndalimi i vdekjes nga uria;⁵² ndalimi i sulmeve kundër objekteve të pazëvendësueshme për

³³ Shih *Customary International Humanitarian law*, supra note 4, Vol. I, Rules 1 and 7.

³⁴ Shih *ibid*; Rules 11 – 13.

³⁵ Shih *ibid*; Rule 14.

³⁶ Shih *ibid*; Rules 15-24.

³⁷ Shih *ibid*; Rules 25 dhe 27-30.

³⁸ Shih *ibid*; Rules 31-32.

³⁹ Shih *ibid*; Rule 34.

⁴⁰ Shih *ibid*; Rule 46.

⁴¹ Shih *ibid*; Rules 36-37.

⁴² Shih *ibid*; Rules 46-48.

⁴³ Shih *ibid*; Rule 53.

⁴⁴ Shih *ibid*; Rule 54.

⁴⁵ Shih *ibid*; Rules 57-65.

⁴⁶ Shih *ibid*; Rules 87-105.

⁴⁷ Shih *ibid*; Rule 117.

⁴⁸ Shih *ibid*; Rules 134-137.

⁴⁹ Shih *ibid*; Rule 1.

⁵⁰ Shih *ibid*; Rules 25 dhe 27-30.

⁵¹ Shih *ibid*; Rule 26.

⁵² Shih *ibid*; Rule 53.

mbijetesën e popullatës civile;⁵³ obligimi për të respektuar garancitë fundamentale të civilëve dhe personave *hors de combat*;⁵⁴ obligimi për të kërkuar, gjetur, respektuar dhe mbrojtur të plagosurit, të sëmurët dhe anijembyturit;⁵⁵ obligimi për të kërkuar dhe mbrojtur të vdekurit;⁵⁶ obligimi për të mbrojtur personat e privuar nga liria;⁵⁷ ndalimi i lëvizjes me dhunë të civilëve;⁵⁸ dhe mbrojtja e veçantë e garantuar për gratë dhe fëmijët.⁵⁹

Mirëpo, kontributi më i rëndësishëm i të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore dhe Humane Ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve të armatosura të brendshme kosiston në faktin se ai i tejkalon dispozitat e Protokollit Shtesë II. Ç’është e vërteta, vet praktika ka krijuar një numër të kosiderueshme të rregullave zakonore që janë më të hollësishme se sa dispozitat e shpeshta dhe të përgjithshme të Protokollit Shtesë II dhe në këtë mënyrë, kanë mbushur zbrazëti të mëdha në zgjidhjen e konflikteve të brendshme.

Kështu bie fjala, Protokollit Shtesë II përmban vetëm rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe qëndrimit gjatë armiqësive. Neni 13 parashikon se “popullata civile si e tillë, së bashku me civilët individual nuk duhet të jetë shënjestër e sulmit, pos nëse ajo në atë kohë merr pjesë drej për së drejti në armiqësi”. Për ndryshim nga Protokollit I, Protokollit II nuk ka rregulla dhe definicione të veçanta mbi parimet e dallimit dhe të masës së caktuar.

Ndërkaq, zbrazëti në rregullimin e sjelljes gjatë armiqësive në Protokollin Shtesë II janë plotësuar nga praktika shtetërore, gjë që ka shpënë drejt formimit të rregullave paralele me ato të Protokollit Shtesë I, por që janë të zbatueshme si ligj zakonor në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Kjo i mbulon edhe parimet bazë të sjelljes gjatë armiqësive dhe i përfshin rregullat për mbrojtjen e personave dhe objekteve të veçanta dhe të metodave specifike të luftës.⁶⁰

Veç kësaj, Protokollit Shtesë II përmban vetëm një dispozitë tejet të përgjithësuar mbi ndihmën humanitare e cila i shpërndahet popullatës nevojtare. Neni 18 (2) parashikon se “nëse popullata civile është duke pësuar nga vuajtjet e tepërta për shkak të mungesës së artikujve ushqimor esenciale për jetesë ... atëherë duhet të ndërmerren pa dallim aksione të paanshme humanitare në favorë të popullatës civile që kanë ekskluzivisht karakter humanitar”. Për dallim nga Protokollit Shtesë I, Protokollit Shtesë II nuk përmban dispozita të veçanta që kërkojnë respektimin dhe mbrojtjen e personelit të ndihmës

⁵³ Shih *ibid*; Rule 54.

⁵⁴ Shih *ibid*; Rules 87-105.

⁵⁵ Shih *ibid*; Rules 109-111.

⁵⁶ Shih *ibid*; Rules 112-113.

⁵⁷ Shih *ibid*; Rules 118-119, 121 dhe 125.

⁵⁸ Shih *ibid*; Rule 129.

⁵⁹ Shih *ibid*; Rules 134-137.

⁶⁰ Shih p.sh; *ibid*; Rules 7-10 (dallimi midis objekteve civile dhe objektivave ushtarake), Rules 11-13 (sulmet e rrëmujshme), Rule 14 (përpjesëtimi i caktuar në sulm), Rules 15-21 (masat paraprake në sulm); Rules 22-24 (masat paraprake kundër efekteve të sulmit); Rules 31-32 (personeli i ndihmës humanitare dhe objekteve); Rule 34 (gazetarët civil); Rules 35-37 (zonat e mbrojtura); Rules 46-48 (mos sigurimi i strehimit); Rules 55-56 (marrja e ndihmës humanitare); dhe Rules 57-65 (mashtrimi).

humanitare të objekteve dhe palët në konflikt, të cilat duhet që të lejojnë dhe të lehtësojnë sigurimin e shpejtë dhe të papenguar të ndihmës humanitare për civilët nevojtarë dhe të sigurojnë lirinë e lëvizjes të personelit të ndihmës humanitare. Sidoqoftë, mund të thuhet se kërkesat e këtilla janë të përfshira në Nenin 18 (2) të Protokollit. Këto kërkesa tashmë janë mpleksur në të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore e cila përdoret si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe jondërkombëtare si pasojë e një praktike pothuaj se unike, të gjerë dhe reprezentative.

Në këtë aspekt, duhet shtuar se ndërsa si Protokoli Shtesë I ashtu edhe Protokoli Shtesë II kërkojnë pëlqimin e palëve të interesuara për aksionet e ndihmës humanitare,⁶¹ pjesa më e madhe e praktikës së regjistruar nuk përmend këtë kërkesë. Por, është më se e qartë se një organizatë humanitare nuk mund të veprojë pa pëlqimin e palës së interesuar. Mirëpo, një pëlqim i këtillë nuk duhet të refuzohet për motive arbitrare. Nëse kostatohet se popullatës civile i kanoset rreziku prej vdekjes nga uria dhe organizata humanitare e cila siguron ndihmë të mbështetur në parimet e paanshmërisë dhe jondasisë është në gjendje ta përmirësojë situatën, atëherë pala është e detyruar ta jep pëlqimin.⁶² Ndërsa, pëlqimi ndoshta nuk mund të sigurohet për arsye teknajoze, praktika njeh raste kur pala e interesuar mund të ushtrojë kontrollë në aksionin e ndihmës, kurse personeli i ndihmës humanitare në atë rast duhet të respektojë ligjin vendor për të hyrë në territorin përkatës ku ka masa të sigurimit.

Disa çështje që kërkojnë sqarime të mëtejme

Ky studim po ashtu ka hedhur dritë mbi një numër të rajoneve ku praktika nuk është aq e qartë. Kështu bie fjala, ndërsa termat “luftëtarët” dhe “civilët” janë përcaktuar qartazi në konfliktet e armatosura ndërkombëtare,⁶³ në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, gjatë armiqësisë mbetet e paqartë e vërteta se a janë anëtarët e grupeve të armatosura kundërshtarë anëtarë të forcave të armatosura apo civilë. Nuk është aq e qartë, sidomos, se a janë anëtarët e grupeve të armatosura kundërshtarë civilë të cilët e humbin mbrojtjen nga sulmi duke marrë pjesë drejt për së drejti në armiqësi, apo anëtarët e grupeve të tilla mund të sulmohen. Kjo mungesë e qartësisë pasqyrohet edhe në traktat ligj. Protokoli Shtojcë II, p.sh., nuk e ka definicionin e civilëve apo të popullatës civile megjithëse këto terma përdoren në disa dispozita.⁶⁴ Traktatet e mëpastajme, që u aplikuan në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, i përdorin në mënyrë të ngjashme termat civilë dhe popullatë civile pa e dhënë definicionin e tyre.⁶⁵

⁶¹ Shih Additional Protocol I, Article 70(1) and Additional Protocol II, Article 18(2).

⁶² Shih Yves Sandoz, Christophe Swinarski, Bruno Zimmerman (eds.), *Commentary on the Additional Protocols*, ICRC, Geneva, 1987, 4885; shih po ashtu 2805.

⁶³ Shih *Customary International Humanitarian Law*, supra note 4, Vol. I, Rule 3 (luftëtarët), Rule 4 (forcat e armatosura) and Rule 5 (civilët dhe popullata civile).

⁶⁴ Additional Protocol II, Article 13-15 and 17-18.

⁶⁵ Shih, p.sh., Amended Protocol II to the Convention on Certain Conventional Weapons, Article 3(7)-(11); Protocol III to the Convention on Certain Conventional Weapons, Article 2; Ottawa Convention on the Prohibition of Anti-personnel Mines, preamble; Statute of the International Criminal Court, Article 8(2)(e)(i), (iii) and (viii).

Një fushë tjetër e pasigurtë që mund të ndikojë në zgjidhjen e konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe jondërkombëtare është edhe mungesa e përcaktimit të përpiktë e sintagmës “pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në armiqësi”. Humbja e mbrojtjes nga sulmi është e qartë dhe e pakontestueshme kur civili përdor armët ose mjetet e tjera për të bërë akte të dhunës kundër forcave njerëzore ose materiale të armikut. Mirëpo, ekziston edhe një praktikë e konsiderueshme e cila ofron pak ose nuk ofron aspak sqarime për interpretimin e shprehjes “pjesëmarrja e drejtpërdrejtë”, duke shtuar, bie fjala se duhet të shqyrtohet çdo rast veç e veç, ose thjeshtë të përsëritet rregulla e përgjithshme se pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në armiqësi u shkakton civilëve humbjen e mbrojtjes nga sulmi. Lidhur me këtë çështje është edhe çështja tjetër se si duhet të trajtohet personi në rast të dyshimit. Për shkak të këtyre pasigurive KNKK-ja është duke bërë përpjekje për ta sqaruar mirëfilli nocionin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë nëpërmjet një sërë takimesh të ekspertëve që kanë filluar që nga viti 2003.⁶⁶

Një çështje tjetër e hapur e kësaj teme është qëllimi i saktë dhe zbatimi i parimit të përpjestueshmërisë adekuate në sulm. Ndërsa studimi gjen një përkrahje të gjerë për këtë parim, ai nuk ofron më tepër sqarime pos sqarimit i cili gjendet në traktat ligjin rreth mundësisë së baraspeshës së avantazhit ushtarak kundër humbjeve të rastësishme të civilëve.

Çështje të zgjedhura mbi zhvillimin e armiqësive

Protokolli Shtojcë I dhe Protokolli Shtojcë II sollën një normë të re duke i ndaluar sulmet mbi impiantët, fabrikat dhe instalacionet që përmbajnë fuqi të rrezikëshme, si dhe aty ku këto objekte janë objektiva ushtarake, kur një sulm i këtillë mund të shkaktojë lirim të fuqive të rrezikshme dhe si pasojë humbje të mëdha midis popullatës civile.⁶⁷ Ndërsa nuk është e qartë nëse këto rregulla specifike janë bërë pjesë përbërëse e të Drejtës Zakonore, praktika tregon se shtetet janë të vetëdijëshme për shkallën e lartë të rrezikshmërisë nga shkaktimi i humbjeve të rastësishme dhe të mëdha që mund të jenë si pasojë nga sulmet mbi impiante, fabrika dhe instalacione të këtilla kur janë objektiva ushtarake. Së këndejmi, ato pranojnë se në çdo lloj konflikti të armatosur duhet të kihet kujdes të madh me rastin e sulmit në mënyrë që të evitohet lrimi i fuqive të rrezikshme dhe si pasojë humbjet e mëdha midis popullatës civile. Kjo kërkesë si u konstatua ishte pjesë përbërëse e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore që zbatohet në çdo lloj konflikti të armatosur.

Një normë e re që iu shtua në Protokollit Shtojcë I është ndalimi i përdorimit të metodave ose mjeteve të luftës që synojnë ose mund të shkaktojnë dëme të mëdha dhe afatgjate mjedisit natyror. Që nga aprovimi i Protokollit Shtojcë I, kjo ndalesë ka hasur në një mbështetje aq të gjerë në praktikën shtetërore sa që është njësuar edhe shndërruar në të Drejtën Zakonore, megjithëse shtetet vazhdimisht kanë pasur qëndrim se kjo normë nuk vlenë për armët bërthamore, prandaj ato nuk e konsiderojnë si të obligueshëm kur është

⁶⁶ Shih, p.sh., Direct Participation in Hostilities under International Humanitarian Law, report prepared by the International Committee of the Red Cross, Geneva, September 2003, available on www.iccr.org.

⁶⁷ Additional Protocol I, Article 56(1) (megjithatë, është e përcjellur nga perjashtimet në paragrafin 2) and Additional Protocol II, Article 159 (pa perjashtime).

fjala për armët bërthamore.⁶⁸ Përveç kësaj rregulle të posaçme, ky studim ka konstatuar se mjedisi natyror konsiderohet si objekt civil dhe si i këtillë është mbrohet nga parimet dhe rregullat e njëjta që i mbrojnë objektet e tjera civile, veçanërisht parimet e dallimit dhe të përpjestueshmërisë dhe të nevojës për të ndërmarrë masa paraprake në sulm. Kjo do të thotë se asnjë pjesë e mjedisit natyror nuk mund të jetë shënjestër e sulmit, pos nëse është objektiv ushtarak, ndërsa si dihet, ndalohet sulmi kundër një objektive ushtarake që mund të shkaktojë dëme të rastësishme për mjedisin që mund të kenë përpjestime më të gjera se dëmet konkrete të parashikuara nga sulmi ushtarak. Gjykata Ndërkombëtare në qëndrimin e tij këshilldhënës në *Rastin e armëve bërthamore*, bie fjala, thekson se “shtetet duhet të ndërmarrin masa mbrojtëse për mjedisin kur vendosin se çfarë është e nevojshme dhe e lejueshme në zgjedhjen e objektivave ushtarake legjitime”.⁶⁹ Veç kësaj palët nga palët në konflikt kërkohet që të ndërmarrin masa të përshtatshme gjatë zhvillimit të armiqësive në mënyrë që t’iu shmangen, madje të zvogëlojnë dëmet eventuale të mjedisit. Mungesa e sigurisë shkencore mbi përmasat e dëmtimit të mjedisit nga disa operacione ushtarake nuk i shfajëson palët në konflikt që të marrin masa të këtilla paraprake.⁷⁰

Janë edhe disa çështje të tjera të cilat nuk janë përmendur në Protokollin Shtojcë. Kështu, p.sh., Protokollin Shtojcë nuk kanë asnjë dispozitë të veçantë që ka të bëjë me mbrojtjen e personelit dhe të objekteve që janë të përfshira në operacionet paqëruajtëse. Ndërkaq, në praktikë personeli dhe objektet e këtilla parashikohet të mbrohen nga sulmet e tilla njësoj sikurse civilët dhe objektet përkatëse civile. Si rrjedhojë, një normë është shndërruar në praktikën shtetërore dhe është përfshirë në statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Ajo ndalon sulmet kundër personelit dhe objekteve të përfshira në misionin paqëruajtës në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, përderisa kanë të drejtën e mbrojtjes së civilëve dhe objekteve civile që janë nën mbrojtjen e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Ajo tani është pjesë e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore dhe është e aplikueshme në çdo lloj të konfliktit të armatosur.⁷¹

Një numër i veçantë i çështjeve lidhur me zhvillimin e armiqësive janë të rregulluara në bazë të Rregullores së Hagës. Këto rregulla për një kohë të gjatë janë konsideruar si zakonore në konfliktet e armatosura ndërkombëtare.⁷² Mirëpo, disa norma të tjera tanimë janë pranuar si rregulla zakonore në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Kështu, fjala vjen, rregullat e kahershme të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore që ndalojnë (1) shkatërrimin ose konfiskimin e pasurisë së kundërshtarit, pos nëse një gjë e këtillë bëhet nga nevojat e domosdoshme ushtarake, dhe (2) grabitjen, vlejnjë njësojë edhe për konfliktet e armatosura ndërkombëtare. Grabitja ose plaçkitja është marrja me dhunë e pronës private nga shtetasit e armikut për qëllime private ose personale.⁷³ Këto ndalime

⁶⁸ Shih *Customary International Humanitarian Law*, supra note 4, Vol. I, Rule 45.

⁶⁹ International Court of Justice, *Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons*, supra note 8, 30.

⁷⁰ Shih *Customary International Humanitarian Law*, supra note 4, Vol. I, Rule 44.

⁷¹ Shih. *Ibid.* Rule 33.

⁷² Shih, p.sh., International Military Tribunal at Nuremberg, *Case of the Major War Criminals*, Judgment, 1 October 1946, *Official Documents*, Vol. I, pp. 253-254

⁷³ Shih *Elements of Crimes for the International Criminal Court*, Pillage as a war crime (Article 8(2)(b)(xvi) and (e)(v) of the Statute of the International Criminal Court).

nuk ndikojnë në praktikën zakonore për të marrë pre ose plaçkë të luftës që i përkasin palës kundërshtare.

Në bazë të të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore, komandatët mund të vëjnë kontakt joarmiçësor nëpërmjet mjeteve të komunikimit, mirëpo një kontakt i këtillë duhet të bazohet në një qëllim të mirë. Praktika dëshmon se komunikimi mund të zhvillohet nëpërmjet ndërmjetësve të cilët njihen si *parlamentarë*, por edhe me anë mjeteve të tjera, si p.sh. telefonit dhe radios. *Parlamentari* është një person që i takon palës në konflikt, i cili është i autorizuar për të komunikuar me palën tjetër në konflikt dhe i cili, së këndejmi, është i paprekshëm. Metoda tradicionale për ta marrë rolin e parlamentarit është të veprosht duke mbjatur një flamur të bardhë; kjo është një metodë e cila ende vlenë. Veç kësaj, nga përvoja dihet se palët ndërluftuese mund t'i drejtohen palës së tretë për të arritur një komunikim më të lehtë, p.sh., një fuqije mbrojtëse apo një organizatë humanitare neutrale, e cila merr rolin e zëdhënësës, veçanërisht KNKK-ja, por edhe ndonjë organizatë ndërkombëtare ose fuqije paqëruajtëse. Praktika e deritanishme tregon se institucionet dhe organizatat e ndryshme kanë luajtur rolin e ndërmjetësve në negociata si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe në konfliktet e armatosura jondërkombëtare dhe se kjo praktikë në përgjithësi është e zakonshme dhe e pranueshme. Rregullat dhe normat që vlejnë për *parlamentarin* datojnë nga Rregullorja e Hagës dhe për një kohë të gjatë konsiderohen si norma zakonore në konfliktet e armatosura ndërkombëtare. Në saje të praktikës së këtyre 50 vjetëve të fundit, ato janë bërë rregulla zakonore edhe në konfliktet e armatosura jondërkombëtare.⁷⁴

Praktika e deritashme ka konstatuar dy lloj interpretimesh të ligjit që e mbron pronën kulturore. Interpretimi i parë daton nga Rregullorja e Hagës dhe kërkon që të kushtohet vëmendje e veçantë që gjatë operacioneve ushtarake të shmangen dëmtimet e ndërtesave religjioze, të artit, të shkencës, të arsimit ose të ndërtesave humanitare dhe monumenteve historike, pos në mos qofshin objektiva ushtarake. Ai po ashtu ndalon konfiskimin apo shkatërrimin ose edhe dëmtimin me paramendim të ndërtesave dhe monumenteve të këtilla. Ndërsa këto norma për një kohë të gjatë janë konsideruar si zakonore në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, ato tani janë pranuar si zakonore edhe në konfliktet e armatosura jondërkombëtare.

Interpretimi i dytë bazohet në dispozitat e veçanta të Konventës së Hagës për Mbrojtjen e Pronës Kulturore të vitit 1954, e cila e mbron “pronën me një rëndësi tejet të madhe për trashëgimin kulturore të çdo populli” dhe parashikon një shenjë të veçantë dalluese për identifikimin e një prone të këtillë. Sot e Drejta Zakonore kërkon që objektet e tilla jo vetëm të mos sulmohen por edhe të mos përdoren për qëllime që ka të ngjarë që t'i ekspozojnë ato shkatërrimit ose dëmtimit, pos nëse është kërkesë e domosdoshme ushtarake. Ajo po kështu ndalon çdo formë të vjedhjes, plaçkitjes apo shpërdorimit si dhe çdo lloj të vandalizmit ndaj një pasurie të tillë. Këto ndalesa përkrijnë me dispozitat e Konventës së Hagës dhe janë dëshmi të ndikimit të kësaj Konvente në praktikën e shteteve për mbrojtjen e pasurisë së rëndësishme kulturore.

⁷⁴ Shih *Customary International Humanitarian Law*, *supra* note 4, Vol. I, Rule 67-69.

Armët

Parimet e përgjithshme të cilat ndalojnë përdorimin e armëve që shkaktojnë lëndime të tepërta ose vuajtje të panevojshme, si dhe të armëve që për nga natyra janë të dëmshme, është konstatuar se janë parime zakonore në çdo konflikt të armatosur. Veç kësaj, kryesisht në bazë të këtyre parimeve, praktika shtetërore ka ndaluar (disa lloje të përdorimit) një numër të armëve të veçanta në bazë të të Drejtës Zakonore Ndërkombëtare Zakonore: helmim ose armët me helm; armët biologjike; armët kimike; mjetet për shpërndarjen e trazirave si metodë të luftës; herbicidet si metodë të luftës;⁷⁵ plumbat që depërtojnë lehtë në trupin e njeriut; përdorimi i plumbave që shpërthejnë brenda trupit të njeriut; armët, efekti primarë i të cilave është që të plagosin me copëzat e vogla që nuk i zbulojnë as rrezet X (iks) në trupin e njeriut; objektet e minuara, që janë të lidhura me objektet ose personat që gëzojnë mbrojtje të veçantë sipas të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, ose objektet që mund t'i tërheqin civilët; dhe armët me lazer që në luftë synojnë dhe përdoren veçanarësh për shkakimin e verbërisë së përhershme apo të dëmtimit të shqisës së të pamurit.

Disa armë që nuk janë të ndaluara si të këtilla nga e Drejta Zakonore, megjithatë u nënshtrohen kufizimeve. Një rast i kësajsoji, janë minat tokësore dhe armët ndezëse. Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar edhe zvogëlimin të dëmtimeve nga minat tokësore. Kjo përfshin, bie fjala, parimin që pala në konflikt e cila i përdor minat tokësore duhet t'i shënojë vendet e minuara sa më tepër që mundet. Po kështu në fund të armiqësive aktive, pala në konflikt e cila i ka përdor minat tokësore, duhet t'i largojë apo t'i çmontojë ato, ose edhe ta lehtësojë largimin e tyre.

Me mëse 140 ratifikime të Konventës së Otavës dhe të tjerëve që pritet ta ratifikojnë, shumica e shteteve kanë obligim sipas traktatit që mos të përdorin më, mos të prodhojnë, mos të krijojnë rezerva dhe mos t'i transferojnë minat toksore kundër njeriut. Ndërsa kjo ndalesë nuk është ende pjesë përbërëse e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore për shkak të një praktike të kundërt dhe të rëndësishme të atyre shteteve që nuk janë nënshkruese të Konventës, pothuaj se të gjitha shtetet, duke përfshirë edhe ato që nuk e kanë nënshkruar Konventën e Otavës, dhe nuk janë në favor të ndalimit të tyre të shpejtë, e kanë parë të udhës që të bashkëpunojnë për eliminimin e minave tokësore kundër njeriut.

Përdorimi i armëve ndezëse kundër njeriut është i ndaluar, pos rasteve kur mund të përdoren armë më pak të dëmshme për ta detyruar një person që të dalë nga lufta (*hors de combat*). Përveç kësaj, nëse përdoren këto armë, atëherë duhet patur kujdes të veçantë që të shmangen ose të zvogëlohen patjetër humbjet e rastësishme e jetës së civilëve, lëndimi dhe plagosja e civilëve dhe dëmtimi i objekteve civile.

⁷⁵ Ky rregull nënkupton referencën lidhur me një numër të rregullave të tjera të Drejtës Zakonore Ndërkombëtare, respektivisht, me ndalimin e armëve biologjike dhe kimike, ndalimin e sulmeve kundër vegjetacionit i cili nuk është objektiv ushtarak; ndalimin e sulmeve që mund të shkaktojnë humbje të rastësishme të jetës së civilëve, lëndimin e tyre, dëmtimin e objekteve civile, ose kombinimin e këtyre, të cilët parashikohet se mund të jenë më të mëdha e më të tepruara se avantazhi ushtarak i parashikuar konkret dhe i drejtëpërdrejtë; dhe ndalimi i shkakimit të dëmtimit të madh, të gjatë dhe të gjerë të mjedisit natyror. Shih *ibid.*; Rule 76.

Shumica e këtyre rregullave janë në pajtim me dispozitat e Traktatit që më parë është përdorur vetëm në konfliktet e armatosura ndërkombëtare. Kjo tendencë gradualisht ka marrë edhe një kahje tjetër të kundërt, si p.sh., në bazë të amendamentit të Protokollit II të Konventës mbi disa Armë Konvencionale të viti 1996, që vlen po ashtu për konfliktet e armatosura jondërkombëtare dhe, së voni në bazë të amendamentit të Konventës mbi disa Armë Konvencionale të vitit 2001 për përhapjen e aplikimit të Protokolleve I-IV edhe në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Ndalesat zakonore dhe kufizimet e lartpërmendura zbatohen në të gjitha konfliktet e armatosura. Kur KNKK-ja e mori mandatin për të përgatitur studimin mbi të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore Humanitare, Gjykata Ndërkombëtare po e shqyrtonte legjitimitetin e kërcënimit ose të përdorimit të armëve bërthamore, pas kërkesës për këshilldhënie nga Kuvendi i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kështu, KNKK-ja vendosi që mos ta analizojë vet këtë çështje. Duke e dhënë mendimin e vet këshillues, Gjykata Ndërkombëtare njëzëri erdhi në përfundimin se “përdorimi i armëve bërthamore duhet të jetë në pajtim me kërkesat e të Drejtës Ndërkombëtare në konfliktet e armatosura, veçanërisht me parimet dhe rregullat e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.”⁷⁶ Ky konstatim është i rëndësishëm duke marrë parasysh se një numër i caktuar shtetesh kanë filluar bisedimet për Protokollin Shtesë I, me qëllim që të arrijnë mirëkuptim se Protokollin nuk do të vlejë për përdorimin e armëve bërthamore. Ndërkaq, opinionin e Gjykatës është se rregullat mbi zhvillimin e armiqësive si dhe parimet e përgjithshme për përdorimin e armëve vlejné edhe për përdorimin e armëve bërthamore. Në zbatimin e këtyre parimeve dhe rregullave, Gjykata erdhi në përfundimin se kërcënimi ose përdorimi i armëve bërthamore është, në përgjithësi, në kundërshtim me rregullat e të Drejtës Ndërkombëtare që zbatohen në konfliktet e armatosura, veçanërisht, me parimet dhe rregullat e të Drejtës Humanitare.⁷⁷

Garancitë themelore

Garancitë themelore vlejné për të gjithë civilët e fuqisë e cila është palë në konfliktë dhe të cilët nuk kanë marrë pjesë ose kanë pushuar të marrin pjesë të drejtpërdrejtë në armiqësi, nga një anë, e nga ana tjetër, vlen për të gjithë personat të cilët janë *hors de combat*. Meqë garancitë themelore i mbulojnë rregullat që vlejné për të gjithë personat, ato nuk u ndanë në pjesë dhe rregulla të veçanta që kanë të bëjnë me personat e llojeve të ndryshme.

Të gjitha garancitë themelore kanë bazën e tyre të sigurt në të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare që zbatohet si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Në këtë studim, shumica e rregullave që u përkasin garancive themelore, janë formuluar në gjuhën juridike tradicionale dhe humanitare, sepse një gjë e këtillë e pasqyrore më së miri substancën e rregullës

⁷⁶ International Court of Justice, *Legality of the Threat of Use of Nuclear Weapons*, *supra* note 8, p. 226.

⁷⁷ *Ibid.*; shih poashtu United Nations General Assembly, 51st session, First Committee, Statement by the International Committee of the Red Cross, UN Doc. A/C.1/51/PV.8, 18 October 1996, p. 10, reproduced in International Review of the Red Cross, No. 316, 1977, pp. 118-119 (“KNKK-ja e konstaton se është e vështirë që të parashihet se si përdorimi i armëve bërthamore mund të jetë në pajtim me rregullat e të drejtës ndërkombëtare.

zakonore përkatëse⁷⁸. Mirëpo, disa rregulla janë formuluar në mënyrën që të përfshijnë esencën e një sërë dispozitash të rëndësishme lidhur me një subjekt specifik, veçanërisht rregullat që ndalojnë punën e detyrueshme të pushpërblyer dhe poshtëruese, zhdukjet me dhunë, arrestimin arbitrar dhe rregullën që parashikon respektin për jetën familjare.⁷⁹

Aty ku është e rëndësishme, praktika e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare është përfshirë në këtë studim, veçanërisht në kapitullin për garancitë themelore. Një gjë e këtillë është bërë për arsye se e Drejta Ndërkombëtare Humanitare vazhdon të vlejë dhe të përdoret gjatë konflikteve të armatosura, ashtu si është theksuar edhe në traktatet e të Drejtës Humanitare, megjithëse disa dispozita, duke u nënshtruar disa kushteve të caktuara, mund të çenohen me rastin e urgjencës publike. Zbatimi i vazhdueshëm i të Drejtës Humanitare gjatë konfliktit të armatosur është konfirmuar në shumë raste në praktikën shtetërore dhe nga agjencitë ose organizatat e të Drejtës Humanitare si dhe nga Gjykata Ndërkombëtare.⁸⁰ Kohë më parë, Gjykata, duke e shprehur mendimin e vet këshilldhënës për pasojat juridike të ndërtimit të murit në territoret e pushtuara palestineze, konfirmoi se mbrojtja e ofruar nga Konventat e të Drejtës Humanitare nuk pushon së vlejuri edhe në rastet e konflikteve të armatosura, dhe, megjithëse, mund të ketë edhe të drejta që janë ekskluzivisht çështje të të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare ose të Ligjit për të Drejtat e Njeriut, ose ka dhe ligje të tjera “që mund të jenë lëndë trajtimi e këtyre dy degëve të të Drejtës Ndërkombëtare”.⁸¹ Ky studim nuk ka për qëllim që të sigurojë vlerësimin e të Drejtës Zakonore Humane. Por në vend të kësaj përvoja e ligjit të drejtave njerëzore është përfshirë në të me qëllim që të mbështesë, forcojë dhe të sqarojë parimet analoge të të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.

Zbatimi

Një numër i konsiderueshëm i rregullave mbi zbatimin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare është bërë pjesë përbërëse e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore. Me këtë rast, para së gjithash, çdo palë në konflikt duhet të respektojë dhe të sigurojë respekt për zbatimin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare nga ana e forcave të saj të armatosura si dhe nga personat ose grupet të cilët veprojnë (në të vërtetë) nën udhëzimet e saj ose të cilët janë nën kontrollin direkt të saj. Si pasojë, secila palë në konflikt, duke përfshirë edhe grupet e armatosura kundërshtarë, duhet të sigurojnë udhëzime dhe instruksione forcave të tyre të armatosura mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare. Përveç këtyre

⁷⁸ Këto rregulla përfshijnë garancitë themelore dhe kërkojnë që civilët dhe personat *hors de combat* të trajtohen në mënyrë njerëzore pa ndonjë ndasi armiqësore të ve/antë; parashikojnë edhe ndalimin e vrasjeve; ndalimin e torturës, të trajtimit të vrazhdë, jo human si dhe dhunën ndaj dinjitetit personal, ve/anërisht trajtimin poshtëruar dhe degradues; ndalimin e ndëshkimit trupor; ndalimin e gjymtimit, të eksperimentimit mjekësor apo shkencor; ndalimin e dhunimit dhe të formave të tjera të dhunës seksuale; ndalimit të skllavërisë dhe të tregtisë robërve në të gjitha format e saj; ndalimin e pengmarrjes; ndalimin e përdorimit të mburojave njerëzore; pastaj parashikon garancinë për gjykim të drejtë; ndalimin e ndëshkimeve kolektive; dhe sigurimin e respektit për pikëpamjet, bindjet dhe veprimtarinë religjioze të civilëve dhe të personave *hors de combat*. Shih *Customary International Humanitarian Law*, supra note 4, Vol. I, Rules 87-94, 96-97 and 100-104.

⁷⁹ Shih *ibid.*, Rules 95, 98-99 and 105

⁸⁰ Shih *ibid.*, Introduction to Chapter 32, Fundamental Guarantees.

⁸¹ International Court of Justice, *Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory*, Advisory Opinion, 9 July 2004, p. 106.

obligimeve të përgjithshme, nuk është aq e qartë se në ç' masë mekanizmat e tjerë të veçantë të zbatimit që janë obligime të shteteve, duhet të jenë të obligueshme edhe për grupet e armatosura të kundërshtarit. Fjala vjen, obligimi për të dhënë urdhëra dhe udhëzime forcave të armatosura të cilat sigurojnë respekt për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare është sqaruar sheshazi në të Drejtën Ndërkombëtare e cila vlen për shtete por jo edhe për grupet e armatosura të kundërshtarit. Në mënyrë të njëjtë, shtetet kanë obligim që të sigurojnë këshilltarë juridikë, kur e lyp nevoja për t'i këshilluar komandantët ushtarakë për shkallën e duhur të dijes në zbatimin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, por kjo nuk vlenë edhe për grupet e armatosura të kundërshtarit.

Për më tepër, shteti është përgjegjës për shkeljen e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare të cilën e njeh dhe ka për detyrë që të sigurojë dëmshpërblim për humbjet ose lëndimet e shkaktuara nga shkelje të tilla. Është e paqartë nëse grupet e armatosura të kundërshtarit kanë një përgjegjësi të barasvlershme për shkeljet e bëra të kësaj të drejte nga anëtarët e tyre dhe çfarë mund të jenë pasojat e një përgjegjësie të tillë. Si u tha më parë, grupet e armatosura duhet të respektojnë të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare dhe njëherish veprimtarinë e tyre duhet ta zhvillojnë “nën një komandë përgjegjëse”.⁸² Ndaj, mund të pohohet se forcat e armatosura të grupeve kanë përgjegjësi për aktet e kryera nga personat që janë pjesëtarë të grupeve të tilla. Konsekuencat e një përgjegjësie të këtillë, megjithatë, nuk janë të qarta. Veçanërisht nuk është e qartë se deri në ç' masë grupet e armatosura të kundërshtarit kanë për obligim që të sigurojnë dëmshpërblim, ndonëse në shumë vende viktimat mund të ngrenë padi për dëmet që u kanë shkaktuar shkelësit e ligjit.

Kur është fjala për përgjegjësinë individuale, e Drejta Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare kërkon përgjegjësi për krimet e bëra nga të gjithë personat të cilët kryejnë krime, japin urdhër për kryerjen e krimeve ose në një mënyrë apo në tjetrën janë përgjegjës si komandantë ose eprorë për kryerjen e krimeve të luftës. Zbatimi i regjimit të krimeve të luftës, ose hetimi i krimeve të luftës si dhe persekutimi i të dyshuarve është obligim që u takon shteteve. Shtetet mund të lirohen nga ky obligim duke formuar gjyqe ndërkombëtare ose gjykata mikste për këtë qëllim.

Përfundim

Ky studim nuk ka bërë përpjekje për të konstatuar karakterin zakonor të çdo norme të traktat ligjit që e pëmban e Drejta Ndërkombëtare Humanitare, por ka synuar për të analizuar çështjet me qëllim të konstatimit se cilat norma të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore mund të konstatohen në mënyrë induktive duke u bazuar në praktikën shtetërore lidhur me këto çështje. Një shqyrtim i shkurtër i disa konstatimeve të këtij studimi, megjithatë, dëshmon se parimet dhe rregullat e të drejtës së traktateve tanimë përdoren gjithnjë e më shpesh në praktikë dhe njëherësh kanë ushtruar ndikim të madh në formimin e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore. Shumica e këtyre parimeve dhe rregullave tani janë pjesë përbërëse e të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore. Si të tilla, ato janë të obligueshme për të gjitha shtetet pa marrë parasysh se a e kanë ratifikuar traktatet

⁸² Additional Protocol II, Article 1(1).

dhe janë të obligueshme edhe për grupet e armatosura të kundërshtarit, si rregulla që zbatohen nga të gjitha palët në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.

Studimi tregon se shumë rregulla të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore vlejné dhe zbatohen si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe në ato jondërkombëtare dhe dëshmon se deri në ç'masë praktika shtetërore e ka tejkaluar traktat ligjin ekzistues duke i përhapur rregullat për zbatim edhe në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Rregullimi i zhvillimit të armiqësive nga një anë, si dhe trajtimi i personave në konfliktet e armatosura të brendshme, nga ana tjetër, del më i hollësishëm dhe më komplet se sa rregullat e të traktat ligjit. Mbetet për t'u shqyrtuar se deri në ç'masë, nga aspekti humanitar dhe ushtarak, kjo normë e hollësishme dhe më complete duhet po ashtu të shqyrtohet nëse ka nevojë edhe për zhvillime të mëtejme të këtij ligji.

Ashtu siç është rasti me traktat ligjin, jetësimi efikas i rregullave të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare përhapet përmes propagandës, trajnimit dhe detyrimit. Këto rregulla duhet të bëhen pjesë e doracakëve ushtarakë dhe legjislacioneve kombëtare, kudo që nuk janë përfshirë ende.

Ky studim zbulon edhe fusha ku ligji nuk është i qartë dhe i identifikon çështjet të cilat kërkojnë sqarime të mëtejme, si p.sh., definimin e civilëve në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, konceptin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në armiqësi dhe qëllimin dhe zbatimin e parimeve në përmasa të caktuara.

Në dritën e këtyre arritjeve të deritanishme dhe të punës që mbetet për t'u bërë akoma, ky studim nuk duhet të vështrohet si një përmbyllje, por më parë si fillim i një procesi të ri që ka për synim kuptimin më të mirë të një marrëveshje mbi parimet dhe rregullat e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Në këtë proces, studimi mund të jetë një bazë e shëndosh për një diskutim të ngjeshur dhe për një dialog mbi zbatimin, sqarimin dhe zhvillimin e mudshëm të ligjit.

Aneks: Lista e rregullave zakonore të të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare

Kjo listë është bazuar në konkluzionet e vëllimit të parë të studimit të të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore dhe Humanitare. Si studim ai nuk synon të përcaktojë karakterin zakonor të çdo rregulle të traktatit të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe nuk e ndjek detyrimisht strukturën e traktateve ekzistuese. Qëllimi i zbatimit të rregullave është shënuar në kllapa katrore. Shkurtesa KAN (në anglisht: IAC), i referohet rregullave zakonore që aplikohen në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, ndërsa shkurtesa KAJN (në anglisht: NIAC), i referohet rregullave zakonore që aplikohen në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Në rastin e fundit, disa rregulla trajtohen si “të diskutueshme” për arsye se në përgjithësi praktika e ka konstatuar këtë, megjithëse edhe ajo nuk është aq gjithëpërfshirëse.

Parimi i dallimit

Dallimi midis civilëve dhe luftëtarëve

Rregulla 1. Palët në konflikt kanë për detyrë që gjithëherë të bëjnë dallimin ndërmjet civilëve dhe luftëtarëve. Sulmet mund të ndërmerren vetëm kundër luftëtarëve. Nuk duhet të bëhen sulme kundër civilëve. (KAN/KAJN)

Rregulla 2. Janë të ndaluara aktet ose kërcënimet me dhunë qëllimi primar i të cilëve është përhapja e terrorit midis popullatës civile. (KAN/KAJN)

Rregulla 3. Të gjithë anëtarët e forcave të armatosura të palëve në konflikt janë luftëtarë, me përjashtim të personelit mjekësor ose religjioz. (KAN)

Rregulla 4. Forcat e armatosura të një pale në konflikt përbëhen prej të gjitha forcave të organizuara të armatosura, grupeve dhe njësisve që janë nën komandën, e cila është përgjegjëse e asaj pale për udhëheqjen e vartësve. (KAN)

Rregulla 5. Civilët janë persona të cilët nuk janë anëtarë të forcave të armatosura. Popullata civile përbëhet nga të gjithë personat të cilët janë civilë. (KAN/KAJN)

Rregulla 6. Civilët janë të mbrojtur nga sulmi, pos nëse në atë kohë nuk marrin pjesë drejtpërsëdrejti në armiqësi. (KAN/KAJN)

Dallimi midis objekteve civile dhe objektivave ushtarake

Rregulla 7. Palët në konflikt duhet që tërë kohën të bëjnë dallimin midis objekteve civile dhe objektivave ushtarake. Sulmet mund të ndërmerren vetëm kundër objektivave ushtarake. Nuk duhet të bëhen sulme kundër objekteve civile. (KAN/KAJN)

Rregulla 8. Sa i përket objekteve, objektivat ushtarake janë të përkufizuara vetëm me ato objekte që për nga natyra, lokacioni, qëllimi ose përdorimi paraqesin një kontribut efikas për veprimtarinë ushtarake dhe shkatërrimi i pjesërishtëm dhe i tërësishëm i tyre dhe pushtimi ose neutralizimi i tyre, në rrethana të asaj kohe, mundësojnë një avantazh definitiv ushtarak. (KAN/KAJN)

Rregulla 9. Objektet civile janë të gjitha objektet që nuk janë objektiva ushtarake. (KAN/KAJN)

Rregulla 10. Objektet civile janë të mbrojtura nga sulmet, pos nëse në atë kohë nuk janë shndërruar në objektiva ushtarake. (KAN/KAJN)

Sulmet e padrejta

Rregulla 11. Sulmet e padrejta janë të ndaluara. (KAN/KAJN)

Rregulla 12. Sulme të padrejta janë këto:

- (a) që nuk bëhen kundër një objektive specifike ushtarake;
- (b) që përdorin metoda ose mjete të luftës të cilat nuk mund të përdoren kundër një objektive specifike ushtarake; ose
- (c) që përdorin metoda ose mjete të luftës efektet e të cilave nuk mund të kufizohen ashtu si kërkon e Drejta Ndërkombëtare Humanitare; dhe së këndejmi janë në gjendje të sulmojnë si objektivat ushtarake ashtu edhe objektet civile pa bërë asnjë dallim. (KAN/KAJN)

Rregulla 13. Ndalohen sulmet përmes bombardimeve me metoda ose mjete të cilat e konsiderojnë si objektivë të veçantë ushtarake një numër të ndarë dhe të dukshëm të objektivave të dalluara ushtarake të vendosura në qytet, qytezë, fshat ose rajon tjetër ku janë të përqëndruar një numër i madh i civilëve ose objekteve civile. (KAN/KAJN)

Përmasat e caktuara në sulm

Rregulla 14. Ndalohet ndërmarrja e sulmit nga i cili pritet të shkaktojë humbje të rastësishme të jetës së civilëve, lëndimin dhe plagosjen e tyre, dëmtimin e objekteve civile ose të gjitha këto, që do të ishte me përmasa të tepruara dhe në mospërputhje me avantazhin e parashikuar konkret dhe të drejtpërdrejtë ushtarak. (KAN/KAJN)

Masat paraprake në sulm

Rregulla 15. Gjatë zhvillimit të operacioneve ushtarake duhet të ndërmerren masa të qëndrueshme me qëllim të kursimit të popullatës civile, civilëve dhe objekteve civile. Duhet të ndërmerren të gjitha masat e mundshme paraprake në mënyrë që të evitohen, ose së paku të zvogëlohen, humbjet e rastësishme të jetës së civilëve lëndimet dhe plagosjet e tyre dhe dëmtimi i objekteve civile. (KAN/KAJN)

Rregulla 16. Secila palë në konflikt duhet të bëjë çmos për të verifikuar në janë apo nuk janë caqet objektiva ushtarake. (KAN/KAJN)

Rregulla 17. Secila palë në konflikt duhet të marrë të gjitha masat e mundshme paraprake gjatë zgjedhjes së mjeteve dhe metodave të luftës me qëllim të evitimit, ose së paku të zvogëlimit, të humbjes së rastësishme të jetës së civilëve, të lëndimit apo plagosjes së civilëve dhe të dëmtimit të objekteve civile. (KAN/KAJN)

Rregulla 18. Secila palë në konflikt duhet të bëjë çmos për të konstatuar se a mund të shkaktojë sulmi humbjen e rastësishme të jetës së civilëve, lëndimin apo plagosjen e tyre, dëmtimin e objekteve civile, apo të gjitha së bashku, që do të ishte një sulm i tepruar në krahasim me avantazhin e parashikuar konkret dhe të drejtpërdrejtë ushtarak. (KAN/KAJN)

Rregulla 19. Secila palë në konflikt duhet të bëjë çmos që të anulojë ose pezullojë një sulm nëse është e qartë se shënjestra nuk është një objektivë ushtarake ose se sulmi mund të shkaktojë humbjen e rastësishme të jetës së civilëve, lëndimin apo plagosjen e tyre, dëmtimin e objekteve civile, apo të gjitha këto së bashku që do të ishte në përpjestim të gabuar në krahasim me avantazhin e parashikuar konkret dhe të drejtpërdrejtë ushtarak. (KAN/KAJN)

Rregulla 20. Secila palë në konflikt duhet të japë një paralajmërim efikas për sulmin që mund ta dëmtojë popullatën civile, pos nëse rrethanat nuk e lejojnë këtë. (KAN/KAJN)

Rregulla 21. Kur ka mundësi të zgjedhjes midis disa objektivave ushtarake për të arritur një përparësi të ngjashme ushtarake, objektivi i zgjedhur duhet të jetë ai për të cilin pritet se do të shkaktojë një rrezik më të vogël për jetën e civilëve dhe objekteve civile. (KAN/diskutabile për KAJN)

Masat paraprake kundër efekteve të sulmeve

Rregulla 22. Palët në konflikt duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat paraprake për të mbrojtur popullatën dhe objektet civile që i kanë nën kontrollin e tyre nga pasojat e sulmeve. (KAN/KAJN)

Rregulla 23. Secila palë në konflikt, me sa ka mundësi, duhet t'i shmanget objektivave ushtarake në ose zonat me popullatë të dendur (KAN/ diskutabile për KAJN)

Rregulla 24. Secila palë në konflikt, me sa ka mundësi, duhet t'i largojë personat civilë dhe objektet që i kontrollojnë nga afërsia e objektivave ushtarake. (KAN/ diskutabile për KAJN)

Personat dhe objektet e mbrojtura në mënyrë të veçantë

Personeli mjekësor, religjioz dhe objektet

Rregulla 25. Personeli mjekësor i cili është përcaktuar për detyra mjekësore duhet të respektohet dhe të mbrohet në të gjitha rrethanat. Ata mund ta humbasin mbrojtjen nëse jashtë veprimtarisë së tyre humanitare kryejnë akte të dëmshme kundër armikut. (KAN/KAJN)

Rregulla 26. Ndalohet dënimi i personit gjatë kryerjes së detyrës së tij mjekësore që është në pajtim me etikën mjekësore, e njëherësh ndalohet edhe detyrimi i një personi të angazhuar në veprimtarinë mjekësore për të kryer akte që janë në kundërshtim me etikën mjekësore. (KAN/KAJN)

Rregulla 27. Personeli religjioz i emëruar ekskluzivisht për detyra religjioze, duhet të respektohet dhe të mbrohet në të gjitha rrethanat. Ata e humbin mbrojtjen nëse jashtë veprimtarisë së tyre humanitare kryejnë akte të dëmshme kundër armikut. (KAN/KAJN)

Rregulla 28. Ekipet mjekësore të caktuara ekskluzivisht për qëllime mjekësore duhet të respektohen dhe të mbrohen në të gjitha rrethanat. Ata e humbin mbrojtjen e tyre nëse jashtë veprimtarisë së tyre humanitare kryejnë akte të dëmshme kundër armikut. (KAN/KAJN)

Rregulla 29. Transportet mjekësore të caktuara ekskluzivisht për transportimin mjekësor duhet të respektohen dhe të mbrohen në të gjitha rrethanat. Ata e humbin mbrojtjen e tyre nëse jashtë veprimtarisë së tyre humanitare kryejnë akte të dëmshme kundër armikut. (KAN/KAJN)

Rregulla 30. Ndalohen sulmet kundër personelit mjekësor, personelit religjioz dhe objekteve që ekspozojnë eblemat e dalluara të konventave të Gjenevës në pajtim me të Drejtën Ndërkombëtare. (KAN/KAJN)

Personeli i ndihmës humanitare dhe objektet

Rregulla 31. Duhet të respektohet dhe të mbrohet personeli i ndihmës humanitare. (KAN/KAJN)

Rregulla 32. Duhet të respektohen dhe të mbrohen objektet që përdoren për veprimtaritë e ndihmës humanitare. (KAN/KAJN)

Personeli dhe objektet e përfshira në misionet paqëruajtëse

Rregulla 33. Ndalohet sulmi kundër personelit dhe objekteve të angazhuara në misionin paqëruajtës në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, përderisa ata e gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së civilëve dhe objekteve civile sipas të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. (KAN/KAJN)

Gazetarët

Rregulla 34. Gazetarët civilë të angazhuar në misionet profesionale në zonat e konfliktit të armatosur, duhet të respektohen dhe të mbrohen përderisa nuk marrin pjesë të drejtpërdrejtë në armiqësi. (KAN/KAJN)

Zonat e mbrojtura

Rregulla 35. Ndalohet sulmi kundër një zone të zgjedhur për strehimin e të plagosurëve, të sëmurëve dhe civilëve nga pasojat e armiqësive. (KAN/KAJN)

Rregulla 36. Ndalohet sulmi kundër zonës së demilitarizuar e cila është caktuar në marrëveshje midis palëve në konflikt. (KAN/KAJN)

Rregulla 37. Ndalohet sulmi kundër lokalitetit të pambrojtur. (KAN/KAJN)

Prona kulturore

Rregulla 38. Secila palë në konflikt duhet ta respektojë pronën kulturore:

- A. Kujdes të veçant duhet kushtuar gjatë veprimtarive ushtarake shmangies nga dëmtimi i ndërtesave të dedikuara fesë, artit, shkencës, arsimit ose qëllimeve bamirëse dhe monumenteve historike, pos nëse ato nuk janë objektiva ushtarake.
- B. Prona me rëndësi të madhe kulturore të çdo populli nuk duhet të jetë objekt Sulmi, pos nëse është nevojë e domosdoshme ushtarake. (KAN/KAJN)

Rregulla 39. Ndalohet përdorimi i një prone me rëndësi të madhe për trashëgimin kulturore të çdo populli për qëllime që ka të ngjarë ta ekzpozojnë atë ndaj shkatërrimit ose dëmtimit, pos nëse është nevojë e domosdoshme ushtarake. (KAN/KAJN)

Rregulla 40. Secila palë në konflikt duhet ta mbrojtë pronën kulturore:

- A. Ndalohet çdo pushtim apo shkatërrim me paramendim i institucioneve fetare, bamirëse, arsimuese, artistike, shkencore, historike, monumenteve dhe veprave artistike dhe shkencës.
- B. Ndalohet çdo formë e vjedhjes, plaçkitjes, ose shpërdorimit, si dhe çdo akt i vandalizmit kundër pronës me një rëndësi tejet të madhe për trashëgimin kulturore të çdo populli. (KAN/KAJN)

Rregulla 41. Fuqia okupuese duhet të parandalojë eksportin e palejueshëm të pronës kulturore nga territori i pushtuar dhe ta kthejë pronën e eksportuar në mënyrë jo ligjore, autoritetit kompetent të territorit të pushtuar. (KAN)

Fabrikat, impiantët dhe instalacionet që përbëjnë fuqi të rrezikshme

Rregulla 42. Nëse sulmohen fabrikat, impiantët dhe instalacionet që përbëjnë fuqi të rrezikshme, respektivisht pendat, digat dhe centralet bërthamore si dhe instalacionet e tjera që gjenden në afërsi të zonës sulmeve, kujdes i veçantë duhet të kihet në mënyrë që të shmanget ose të evitohet lirim i materieve të rrezikshme dhe humbjet e mëdha në mesin e popullatës civile. (KAN/KAJN)

Mjedisi natyror

Rregulla 43. Parimet e përgjithshme të zhvillimit të armiqësive vlejné edhe për mjedisin natyror:

- A. Asnjë pjesë e mjedisit natyror nuk mund të sulmohet, pos nëse është objektiv ushtarak.
- B. Ndalohet shkatërrimi i çdo pjese të mjedisit natyror, pos nëse është kërkesë e domosdoshme ushtarake.
- C. Ndalohet sulmi kundër objektivit ushtarak që mund të shkaktojë dëmtimin e rastësishëm të mjedisit natyror i cili sulm do të ishte me përmasa më të mëdha në krahasim me përparësinë e parashikuar konkrete dhe të drejtpërdrejtë ushtarake. (KAN/KAJN)

Rregulla 44. Metodrat dhe mjetet e luftës duhet të përdoren duke respektuar mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror. Gjatë zhvillimit të veprimtarive ushtarake, duhet të ndërmerren të gjitha masat e mundshme ushtarake që të shmanget ose të zvogëlohet, dëmtimi i rastësishëm i mjedisit natyror. Mungesa e sigurisë shkencore mbi pasojat e disa veprimtarive ushtarake mbi mjedisin natyror nuk e heq përgjegjësinë e palës në konflikt nga marrja e masave të këtilla paraprake. (KAN/ diskutabile për KAJN)

Rregulla 45. Ndalohen metodrat ose mjetet e luftës që kanë për qëllim ose kanë mundësi të shkaktojnë dëme të mëdha dhe me përmasa të gjera dhe afatgjata mjedisit natyror. Shkatërrimi i mjedisit natyror nuk mund të përdoret si armë. (KAN/ diskutabile për KAJN)

Metodat specifike të luftimit

Mohimi i strehimit të përkohshëm

Rregulla 46. Ndalohet dhënia e urdhërit për mosdhënien e strehimit, dhe kërcënimin e kundërshtarit ose zhvillimin e armiqësive me këtë motiv. (KAN/KAJN)

Rregulla 47. Ndalohet sulmi kundër personave të cilët janë të njohur *hors de combat* (që nuk marrin pjesë në luftë). Personi *hors de combat* konsiderohet:

- (a) Ai i cili është nën pushtetin e palës kundërshtare;
- (b) Ai i cili është i pambrojtur për shkak të humbjes së vetëdijës, anijembytjes, plagëve ose sëmundjes; ose

- (c) Ai i cili qartazi e shpreh qëllimin e tij për t'u dorëzuar. Me kusht që të heq dorë nga çdo lloj akti armiqësor dhe të nuk përpiqet për t'u arratisur. (KAN/KAJN)

Rregulla 48. Ndalohet detyrimi i personave që të hidhen me parashutë nga aeroplani mbi objektet që janë cak i sulmit. (KAN/KAJN)

Shkatërrimi ose rrëmbimi i pronës

Rregulla 49. Palët në konflikt mund të rrëmbejnë pajimet që i përkasin palës kundërshtarë si pre të luftës. (KAN)

Rregulla 50. Ndalohet shkatërrimi ose rrëmbimi i pronës së kundërshtarit, pos nëse është kërkesë e domosdoshme ushtarake. (KAN/KAJN)

Rregulla 51. Në territorin e pushtuar:

- (a) Mund të konfiskohet prona publike e lëvizshme që mund të përdoret për veprimtarinë ushtarake;
- (b) Prona e patundshme publike duhet të administrohet sipas rregullit të drejtës së shfrytëzimit të pronës së tjetrit; dhe
- (c) Prona private duhet të respektohet dhe nuk mund të konfiskohet, pos nëse shkatërrimi ose rrëmbimi i një prone të këtillë është nevojë e domosdoshme ushtarake. (KAN)

Rregulla 52. Ndalohet plaçkitja. (KAN/KAJN)

Vdekja me uri dhe mundësia për të siguruar ndihmë humanitare

Rregulla 53. Ndalohet imponimi i vdekjes me uri i popullatës civile si metodë e luftimeve. (KAN/KAJN)

Rregulla 54. Ndalohet sulmi, shkatërrimi ose zhvendosja, apo shndërrimi i objekteve të nevojshme në objekte të papërdorshme, që janë të domosdoshme për mbijetesën e popullatës civile. (KAN/KAJN)

Rregulla 55. Palët në konflikt duhet të lejojnë dhe lehtësojnë qarkullimin e shpejtë dhe të papenguar të ndihmës humanitare për civilët nevojtarë, e cila ndihmë ka karakter të paanshëm dhe pa ndonjë dallim. (KAN/KAJN)

Rregulla 56. Palët në konflikt duhet të sigurojnë lirinë e qarkullimit të personelit të autorizuar të ndihmës humanitare që është e domosdoshme për ushtrimin e detyrës së tyre. Vetëm në rast të nevojës së domosdoshme ushtarake, lëvizja e tyre mund të ndalohet përkohësisht. (KAN/KAJN)

Mashtrimi

Rregulla 57. Dredhit apo truket e luftës nuk janë të ndaluara nëse nuk i cenojnë rregullat e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. (KAN/KAJN)

Rregulla 58. Ndalohet përdorimi i pavend i flamurit të bardhë të armëpushimit. (KAN/KAJN)

Rregulla 59. Ndalohet përdorimi i pavend i simboleve të konventave të Gjenevës. (KAN/KAJN)

Rregulla 60. Ndalohet përdorimi i emblemave dhe uniformave të Kombeve të Bashkuara, pos nëse është i autorizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. (KAN/KAJN)

Rregulla 61. Ndalohet përdorimi i pavend i emblemave apo simboleve të tjera të njohura ndërkombëtare. (KAN/KAJN)

Rregulla 62. Ndalohet përdorimi i pavend i flamujve ose emblemave, stemave, shenjave dalluese ose uniformave të kundërshtarit. (KAN/ diskutabile për KAJN)

Rregullia 63. Ndalohet përdorimi i flamujve ose emblemave ushtarake, stemave, shenjave dalluese ose uniformave të shteteve neutrale ose të shteteve të cilët nuk marrin pjesë në konflikt. (KAN/ diskutabile për KAJN)

Rregulla 64. Ndalohet lidhja e marrëveshjeve për pezullimin e luftimeve me qëllim të sulmit të papritur kundër armikut duke e shfrytëzuar marrëveshjen e arritur. (KAN/KAJN)

Rregulla 65. Ndalohet vrasja, lëndimi, plagosja ose kapja e kundërshtarit përmes dinakërisë. (KAN/KAJN)

Komunikimi me armikun

Rregulla 66. Komandantët mund të vënë kontakt joarmiqësor midis tyre përmes çdo mjeti të komunikimit. Një kontakt i këtillë duhet të mbështetet në mirëbesim dhe të jetë qëllim-mirë. (KAN/KAJN)

Rregulla 67. Parlamentarët janë të paprekshëm. (KAN/KAJN)

Rregulla 68. Komandantët mund të ndërmarrin masa të nevojshme paraprake që të parandalojnë që prania e parlamentarit të mos jetë i përdhunshëm. (KAN/KAJN)

Rregulla 69. Parlamentarët të cilët mund ta shfrytëzojnë avantazhin e pozitës së tyre të privilegjuar për të bërë ndonjë akt që është në kundërshtim me të Drejtën Ndërkombëtare dhe në dëm të kundërshtarit, i humbin privilegjet e tyre. (KAN/KAJN)

Armët

Parimet e përgjithshme të përdorimit të armëve

Rregulla 70. Ndalohet përdorimi i mjeteve dhe i metodave të luftimit që kanë karakter të atillë që mund të shkaktojnë lëndime të mëdha, të tepruara ose vuajtje të panevojshme. (KAN/KAJN)

Rregulla 71. Ndalohet përdorimi i armëve që janë për nga natyra të palejueshme. (KAN/KAJN)

Helmi

Rregulla 72. Ndalohet përdorimi i helmit apo i armëve me helm. (KAN/KAJN)

Armët biologjike

Rregulla 73. Ndalohet përdorimi i armëve biologjike. (KAN/KAJN)

Armët kimike

Rregulla 74. Ndalohet përdorimi i armëve kimike. (KAN/KAJN)

Rregulla 75. Ndalohet përdorimi i mjeteve për kontrollin e trazirave si metodë e luftimit. (KAN/KAJN)

Rregulla 76. Përdorimi i herbicideve si metodë e luftimit ndalohet nëse ato:

- (a) Kanë veçoritë e armëve kimike;
- (b) Kanë veçortinë e armëve biologjike;
- (c) Përdoren kundër një vegjetacioni që nuk është objektiv ushtarak;
- (ç) Do të mund të shkaktonin humbjen e rastësishme të jetës së civilëve, lëndimet e tyre, dëmtimin e objekteve civile, ose të gjitha këto së bashku, ose nëse përdorimi i tyre do të ishte me përmasa shumë më të gjera në krahasim me përparësinë e parashikuar konkrete dhe të drejtpërdrejtë ushtarake; ose
- (d) Do të mund të shkaktonin dëme të gjera, të mëdha dhe afatgjate mjedisit natyror. (KAN/KAJN)

Plumbat zgjërues

Rregulla 77. Ndalohet përdorimi i plumbave zgjërues, ose që përhapen lehtë në trupin e njeriut. (KAN/KAJN)

Plumbat shpërthyes

Rregulla 78. Ndalohet përdorimi i plumbave kundër njeriut që shpërthejnë brenda trupit të njeriut. (KAN/KAJN)

Armët të cilat lëndojnë përmes copëzave të padiktueshme

Rregulla 79. Ndalohet përdorimi i armëve efekti primar i të cilëve është të lëndojnë me anë të copëzave që nuk mund të diktohen përmes rrezeve X (iks) në trupin e njeriut. (KAN/KAJN)

Kurthat dhe objektet e minuara

Rregulla 80. Ndalohet përdorimi i kurthave dhe objekteve të minuara që në një mënyrë apo në tjetrën, janë të lidhura me objektet apo personat që gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë sipas të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, ose të objekteve që ka të ngjarë të jenë tërheqëse për civilët. (KAN/KAJN)

Minat tokësore

Rregulla 81. Kur përdoren minat tokësore, duhet të merren masa të veçanta për të zvogëluar pasojat e tyre të dëmshme. (KAN/KAJN)

Rregulla 82. Pala në konflikt e cila përdor minat tokësore duhet të regjistrojë vendosjen e tyre sa më mirë që është e mundur. (KAN/ diskutabile për KAJN)

Rregulla 83. Në fund të armiqësive aktive, pala në konflikt e cila i ka përdorur minat tokësore, duhet t'i largojë ato apo t'i bëjë të parrezikshme për civilët, ose të ndihmojë në largimin e tyre. (KAN/KAJN)

Armët zjarrëvënëse

Rregulla 84. Nëse përdoren armët zjarrëvënëse, atëherë vëmendje e veçantë duhet kushtuar në mënyrë që të shmangen, ose së paku të zvogëlohen, humbjet e rastësishme të jetës së civilëve, lëndimet e tyre dhe dëmtimi i objekteve civile. (KAN/KAJN)

Rregulla 85. Ndalohet përdorimi kundër njeriut i armëve zjarrëvënëse, pos nëse nuk është e mundshme përdorimi i një arme më pak të dëmshme, e cila do t'i detyronte personat të mbeten *hors de combat*. (KAN/KAJN)

Armët verbuese lazerike

Rregulla 86. Ndalohet përdorimi i armëve lazerike të cilat kanë një qëllim të veçantë, si funksion të vetëm luftarak apo si një ndër funksionet e përdorimit luftarak shkaktimin e verbimit të përhershëm të shqisës së të pamunit. (KAN/KAJN)

Trajtimi i civilëve dhe i personave hors de combat

Garancitë themelore

Rregulla 87. Civilët dhe personat *hors de combat* duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore. (KAN/KAJN)

Rregulla 88. Ndalohet dallimi armiqësor në zbatimin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare mbi baza racore, të ngjyrës, të gjinisë, të gjuhës, të fesë, përkatësisë politike ose mendimit tjetërsoj, të përkatësisë kombëtare ose shoqërore, të pasurisë, të lindjes, ose edhe të ndonjë statusi tjetër, apo edhe në bazë të çdo kriteri tjetër të ngjashëm. (KAN/KAJN)

Rregulla 89. Ndalohet vrasja. (KAN/KAJN)

Rregulla 90. Ndalohet tortura, trajtimi i vrazhdë, jonjerëzor, mizor ndaj dinjitetit personal në përgjithësi, e në veçanti ndalohet edhe trajtimi poshtëruës dhe degradues i personit. (KAN/KAJN)

Rregulla 91. Ndalohet ndëshkimi trupor. (KAN/KAJN)

Rregulla 92. Ndalohen gjymtimi, sakatimi, eksperimentet mjekësore ose shkencore apo edhe çdo lloj procedure tjetër mjekësore e cila nuk është konstatuar nga gjendja shëndetësore e personit në fjalë dhe nuk përkon me standardet e pranuar të përgjithshme mjekësore. (KAN/KAJN)

Rregulla 93. Ndalohet dhunimi dhe format e tjera të dhunës seksuale. (KAN/KAJN)

Rregulla 94. Ndalohet robëria dhe tregëtia me robër në të gjitha format e saj. (KAN/KAJN)

Rregulla 95. Ndalohet puna e pashpërblyer ose e detyruar. (KAN/KAJN)

Rregulla 96. Ndalohet marrja e pengjeve. (KAN/KAJN)

Rregulla 97. Ndalohet përdorimi i mburojave njerëzore. (KAN/KAJN)

Rregulla 98. Ndalohet zhdukja me dhunë. (KAN/KAJN)

Rregulla 99. Ndalohet privimi arbitrar i lirisë. (KAN/KAJN)

Rregulla 100. Askush nuk mund të dënohet pos pas gjykimit të drejtë që do të kishte të gjitha garancitë esenciale juridike. (KAN/KAJN)

Rregulla 101. Asnjëri nuk mund të akuzohet apo dënohet për akte kriminale në saje të ndonjë akti apo lajthitje që nuk përbën një akt kriminal sipas ligjit kombëtar ose ndërkombëtar në kohën e kryerjes së aktit; madje as që mund të kërkohet ndonjë ndëshkim më i rëndë se sa dënimi që zbatohet në kohën e kryerjes së krimit. (KAN/KAJN)

Rregulla 102. Askush nuk mund të dënohet për shkelje të ligjit, pos vetëm nëse mban përgjegjësi për një akt individual kriminal. (KAN/KAJN)

Rregulla 103. Ndalohen dënimet kolektive. (KAN/KAJN)

Rregulla 104. Duhet të respektohen patjetër pikëpamjet, praktika fetare e civilëve dhe e personave *hors de combat*. (KAN/KAJN)

Rregulla 105. Brenda mundësive duhet të respektohet jeta familjare. (KAN/KAJN)

Statusi i luftëtarëve dhe i robërve të luftës

Rregulla 106. Luftëtarët duhet ta dallojnë vetvetën nga popullata civile ndërsa janë të angazhuar në ndonjë sulm apo veprimtari ushtarake parapërgatitore për sulm. Nëse nuk veprojnë kështu, ata nuk e kanë të drejtën ta gëzojnë statusin e robërve të luftës. (KAN)

Rregulla 107. Luftëtarët të cilët zihen rob, ndërsa janë të angazhuar në veprimtaritë e spiunazhit, nuk kanë të drejtë që ta gëzojnë statusin e robërve të luftës. Ata nuk mund të dënohen pa një gjykim të mëparshëm. (KAN)

Rregulla 108. Mercenarët, ashtu siç definohet në Protokollin Shtesë I, nuk kanë të drejtë për ta gëzuar jo vetëm statusin e luftëtarit por as atë të robërve të luftës. Ata nuk mund të dënohen pa një gjykim të mëparshëm. (KAN)

Të plagosurit, të sëmurit dhe anijembyturit

Rregulla 109. Sa herë që mundësojnë rrethanat, e sidomos pas ndonjë përleshjeje të armatosur, secila palë në konflikt duhet pa kurrfarë ngurrimi që të merr të gjitha masat e mundshme për të kërkuar, grumbulluar dhe evakuar të plagosurit, të sëmurët dhe anijembyturit pa kurrfarë dallimi. (KAN/KAJN)

Rregulla 110. Të plagosurit, të sëmurit dhe anijembyturit duhet të kenë mjekimin sa më parë mjekimin adekuat dhe përkujdesjen e duhur për gjendjen e tyre. Midis tyre nuk mund të bëhet kurrfarë dallimi me ndonjë motiv të caktuar pos motivit mjekues. (KAN/KAJN)

Rregulla 111. Secila palë në konflikt duhet të ndërmerrë çdo llojë mase të mundshme për të mbrojtur të plagosurit, të sëmurët dhe anijembyturit nga keqtrajtimi dhe plaçkitja e pronës së tyre personale. (KAN/KAJN)

Të vdekurit

Rregulla 112. Sa herë që të lejojnë rrethanat, veçanërisht pas ndonjë përlëshjeje, secila palë në konflikt duhet pa ngurrim të ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për kërkimin, grumbullimin dhe evakuimin e të vdekurve pa asnjë dallim. (KAN/KAJN)

Rregulla 113. Çdo palë në konflikt duhet të ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për të penguar plaçkitjen e të vdekurve. Ndalohet gjymtimi i kufomave. (KAN/KAJN)

Rregulla 114. Palët në konflikt duhet të bëjnë përpjekje për të mundësuar kthimin e kufomave të të ndjerëve pas kërkesës së palës të cilës ato i takojnë apo me kërkesën e të familjes ose të afërmëve të tyre. Ata duhet t'u kthejnë gjerat e tyre personale. (KAN)

Rregulla 115. Kufomat duhet të trajtohen në mënyrë të respektuar, ndërsa varret e tyre duhet të respektohen dhe mirëmbahen. (KAN/KAJN)

Rregulla 116. Me qëllim të identifikimit të kufomave, çdo palë në konflikt duhet të sigurojë të gjitha informacionet para dorëzimit dhe të shënojë lokacionin e varreve. (KAN/KAJN)

Personat e zhdukur

Rregulli 117. Secila palë në konflikt duhet t'i ndërmerrë të gjitha masat e mundshme në favor të personave për të cilët është raportuar si të zhdukur nga konflikti i armatosur dhe duhet t'i japë anëtarëve të familjes çdo lloj informate për fatin e tyre. (KAN/KAJN)

Personat e privuar nga liria

Rregulla 118. Personat e privuar nga liria e tyre duhet të pajisen me ushqim, ujë, veshmbathje, strehim dhe përkujdesje të duhur mjekësore. (KAN/KAJN)

Rregulla 119. Femrat të cilat janë të privuara nga liria e tyre duhet të jenë në dhoma të ndara nga lokalet e burrave, pos në rastet kur familjet vendosen si tërësi familjare dhe duhet të jenë në mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të femrave. (KAN/KAJN)

Rregulla 120. Fëmijët të cilët janë privuar nga liria e tyre, duhet të jenë në lokale të veçanta prej atyre të rriturve, pos në raste kur familjet vendosen si tërësi familjare. (KAN/KAJN)

Rregulla 121. Personat të cilët janë të privuar nga liria duhet të mbahen në ndërtesa të cilat janë larg nga zonat e luftimeve dhe sigurojnë shëndetin dhe higjenën e tyre. (KAN/KAJN)

Rregulla 122. Ndalohet plaçkitja e gjerave personale të personave të privuar nga liria. (KAN/KAJN)

Rregulla 123. Duhet të regjistrohen hollësitë personale të personave të privuar nga liria. (KAN/KAJN)

Rregulla 124.

- A. Në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, KNKK-ja duhet të ketë të drejtën për të vizituar të gjithë personat e privuar nga liria me qëllim që të verifikojë kushtet e

ndalimit ose paraburgimit, dhe të vejë kontakte ndërmjet atyre personave dhe familjeve të tyre. (KAN)

- B. Në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, KNKK-ja mund të ofrojë shërbimet e saj të gjitha palëve në konflikt në mënyrë që të mundësojë vizitën e të gjithë personave të privuar nga liria për shkak të konfliktit me qëllim që të verifikojë kushtet e ndalimit ose paraburgimit dhe të vejë kontakte ndërmjet atyre personave dhe familjeve të tyre. (KAJN)

Rregulla 125. Personave të privuar nga liria duhet t'u lejohet letërkëmbimi me familjet e tyre. Letërkëmbimi u nënshtrohet kushteve të arsyeshme që varen nga cenzura e shtetit. (KAN/KAJN)

Rregulla 126. Civilëve të internuar dhe personave të privuar nga liria, për shkak të konflikteve të armatosura jondërkombëtare duhet t'u lejohet që të pranojnë vizitues, sidomos anëtarët e familjes dhe të afërmit për aq sa ka mundësi.

Rregulla 127. Duhet të respektohen pikëpamjet, bindjet dhe praktika fetare e personave të privuar nga liria. (KAN/KAJN)

Rregulla 128.

- A. Robërit e luftës duhet të lirohen dhe të riatdhesohen pa asnjë vonesë menjëherë pas ndërprerjes së armiqësive aktive. (KAN)
- B. Të internuarit civil duhet të lirohen posa arsyet të cilat i kanë detyruar ata të internohen nuk ekzistojnë më, ose më së paku sa më parë që të jetë e mundur pas mbarimit të armiqësive aktive. (KAN)
- C. Personat e privuar nga liria për shkak të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, duhet të lirohen menjëherë posa arsyet për privimin e tyre nga liria pushojnë së ekzistuari. (KAJN)

Personat të cilëve u referohemi këtu mund të vazhdojnë të mbeten të privuar nga liria e tyre nëse pritet procedura penale kundër tyre ose nëse janë duke vuajtur dënimin e ligjshëm.

Zhvendosja dhe personat e zhvendosur

Rregulla 129.

- A. Palët në një konflikt të armatosur ndërkombëtar nuk do të mund të deportojnë ose të transferojnë me forcë popullatën civile të territorit të pushtuar, në tërësi ose pjesërisht, në mos për hir të sigurimit të civilëve të përfshirë, ose nëse është nevojë e domosdoshme ushtarake. (KAN)
- B. Palët në një konflikt të armatosur jondërkombëtar nuk mund të japin urdhër për zhvendosjen e popullatës civile, në tërësi ose pjesërisht, për arsye të konfliktit, në mos për hir të sigurimit të civilëve të përfshirë, ose nëse është nevojë e domosdoshme ushtarake. (KAJN)

Rregulla 130. Shtetet ndoshta ka të ngjarë të mos i deportojnë pjesët e popullatës së tyre civile në territorin të cilin e pushtojnë. (KAN)

Rregulla 131. Në rast të zhvendosjes së popullatës, duhet të ndërmerren të gjitha masat me qëllim që civilët të kenë kushte të mjaftueshme për strehim, higjienë, shëndet, siguri, dhe të mos ndahen nga anëtarët e familjes. (KAN/KAJN)

Rregulla 132. Personat e zhvendosur kanë të drejtë të kthehen vullnetarish në siguri në vendbanimet e tyre posa të eliminohen arsyet për zhvendosjen e tyre. (KAN/KAJN)

Rregulla 133. Duhet të respektohen të drejtat pronësore të personave të zhvendosur. (KAN/KAJN)

Personat e tjerë që gëzojnë mbrojtje të veçantë

Rregulla 134. Duhet të respektohet mbrojtja e veçantë, shëndetësore dhe ndihma që u nevojitet femrave të lënduara nga konflikti i armatosur. (KAN/KAJN)

Rregulla 135. Fëmijët e lënduar nga konflikti i armatosur kanë të drejtë për një respekt dhe mbrojtje të veçantë. (KAN/KAJN)

Rregulla 136. Fëmijët nuk duhet të rekrutohen në forcat e armatosura apo në grupet e armatosura. (KAN/KAJN)

Rregulla 137. Fëmijëve nuk duhet t'u lejohet që të marrin pjesë në armiqësitë. (KAN/KAJN)

Rregulla 138. Pleqtë, të paafit, dhe të gjymtuarit, të dëmtuar ose të lënduar në konflikte të armatosura, kanë të drejtë për respekt dhe mbrojtje të veçantë.

Zbatimi

Përputhja me të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare

Rregulla 139. Secila palë në konfliktë duhet të respektojë dhe sigurojë respekt për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare prej forcave të veta të armatosura dhe personave apo grupeve të tjerë që në fakt veprojnë sipas udhëzimeve të saj ose nën drejtimin dhe kontrollin e saj. (KAN/KAJN)

Rregulla 140. Obligimi për respektimin dhe sigurimin e respektit për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare nuk varet nga reciprociteti. (KAN/KAJN)

Rregulla 141. Çdo shtet duhet t'i ketë këshilltarët ligjor, kur të jetë nevoja për t'i këshilluar komandantët ushtarak në shkallë të duhur mbi zbatimin e të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare. (KAN/KAJN)

Rregulla 142. Shtetet dhe palët në konflikt duhet t'u sigurojnë forcave të tyre të armatosura udhëzime mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare. (KAN/KAJN)

Rregulla 143. Shtetet duhet ta inkurajojnë mbajtjen e mësimit për popullatën civile mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare. (KAN/KAJN)

Zbatimi i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare

Rregulla 144. Shtetet nuk do të duhej të inkurajojnë shkeljen e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare nga palët në konfliktet e armatosura. Ato duhet ta ushtrojnë ndikimin e tyre për aq sa mundën për ndalimin e shkeljes së të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. (KAN/KAJN)

Rregulla 145. Atje ku nuk ndalohet nga e Drejta Ndërkombëtare, raprezaliet ndërluftuese u nënshtrohen kushteve të rënda. (KAN)

Rregulla 146. Ndalohen raprezaliet e palëve ndërluftuese kundër personave të mbrojtur nga konventat e Gjenevës. (KAN)

Rregulla 147. Ndalohen raprezaliet kundër objekteve të mbrojtura nga konventat e Gjenevës dhe Konventa e Hagës për Mbrojtjen e Pronës Kulturore. (KAN)

Rregulla 148. Palët në konfliktet e armatosura jondërkombëtare nuk kanë të drejtë të përdorin raprezalie ndërluftuese. Ndalohen kundërmasat e tjera kundër personave të cilët ose nuk duan ose kanë refuzuar të marrin pjesë drejtpërsëdrejti në armiqësitë. (KAJN)

Përgjegjësia dhe kompenzimi

Rregulla 149. Shteti është përgjegjës për shkeljet e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare që i vishen atij, duke përfshirë:

- (a) Shkeljet e bëra nga organet e tij, duke përfshirë edhe forcat e armatosura të tij;
- (b) Shkeljet e bëra nga personat ose njësitë e autorizuara për të ushtruar elementet e pushtetit;
- (c) Shkeljet e bëra nga personat ose grupet që në të vërtetë veprojnë me udhëzimet e tij, nën drejtimin ose kontrollin e tij; dhe
- (ç) Shkeljet e bëra nga personat privat ose grupet që shteti i njeh dhe i pranon si bartës të qëndrimeve të shtetit. (KAN/KAJN)

Rregulla 150. Shteti përgjegjës i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare është i obliguar që të sigurojë kompenzimin e plotë për humbjet ose lëndimet e shkaktuara. (KAN/KAJN)

Përgjegjësia individuale

Rregulla 151. Individët japin përgjegjësi penale për krimet e bëra të luftës. (KAN/KAJN)

Rregulla 152. Komandantët dhe eprorët e tjerë kanë përgjegjësi penale për krimet e luftës të kryera në saje të urdhërave. (KAN/KAJN)

Rregulla 153. Komandantët dhe eprorët e tjerë kanë përgjegjësi penale për krimet e luftës të kryera nga vartësit e tyre nëse e kanë ditur ose kanë pasur arsye të dinë se vartësit e tyre kanë qenë duke u përgatitur për të bërë krime ose kanë bërë krime të tilla, por ata nuk kanë ndërmarrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për ndërprerjen e tyre, ose edhe nëse janë bërë krime të atilla, ata nuk i kanë dënuar personat përgjegjës (KAN/KAJN)

Rregulla 154. Çdo luftëtar ka për detyrë të mos i bindet urdhërit të dhënë kundër ligjor. (KAN/KAJN)

Rregulla 155. Respektimi i urdhërit të eprorit nuk e liron vartësin nga përgjegjësia penale nëse vartësi e ka ditur se akti i urdhëruar ishte kundër ligjor ose ka qenë dashur ta dijë për karakterin kundër ligjor të urdhërit të dhënë. (KAN/KAJN)

Krimet e luftës

Rregulla 156. Krim lufte është shkelja serioze e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. (KAN/KAJN)


Rregulla 157. Shtetet kanë të drejtë të përdorin juridiksionin universal mbi krimet e luftës në gjyqet e tyre kombëtare. (KAN/KAJN)

Rregulla 158. Shtetet duhet të hetojnë krimet e luftës për të cilët është deklaruar se janë kryer nga bashkëkombasit ose forcat e tyre të armatosura në territorin e tyre, dhe nëse e shohin të udhës t'i ndjekin penalisht të dyshuarit. Ata po ashtu duhet të zhvillojnë hetime rreth krimeve të tjera të luftës mbi të cilët kanë jurisdikcion dhe nëse duhet, t'i hedhin në gjyq të dyshuarit. (KAN/KAJN)

Rregulla 159. Në fund të armiqësive, autoritetet që e kanë pushtetin duhet të bëjnë përpjekje për të dhënë një amnesti sa më të gjerë personave të cilët kanë marrë pjesë në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, ose atyre të cilët kanë qenë të privuar nga liria për shkak të konfliktit të armatosur, me perjashtim të personave të dyshuar, të akuzuar, ose të dënuar për krime të luftës. (KAJN)

Rregulla 160. Statutet e kufizimit të kohës nuk do të duhej të vlejnjë për krimet e luftës. (KAN/KAJN)

Rregulla 161. Shtetet duhet të bëjnë çdo lloj përpjekjesh për të bashkëpunuar, me aq sa mundën me njëri tjetrin, me qëllim që t'u ndihmojnë hetimeve për zbulimin e krimeve të luftës dhe përndjekjen penale të të dyshuarve. (KAN/KAJN)



STUDIM MBI TË DREJTËN
NDËRKOMBËTARE
HUMANITARE ZAKONORE



www.icrc.org